REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

GJIROKASTËR

# RAPORTI I VETËVLERËSIMIT

# PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL

GRUPI I VETËVLERËSIMIT:

1. Valbona Duri Kryetar
2. Jaho Cana Anëtar
3. Gëzim Rredhi Anëtar
4. Eduina Guga Anëtar
5. Isidor Kokalari Anëtar
6. Klaviora Dudumi Anëtar
7. Sara Bixhaku Anëtar (Student)

Data: 19. 02. 2021

## PËRMBAJTJA

Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit....4

I. Historiku i IAL.... 7

II. Misioni....11

III. Vizioni....11

1. FUSHA E VLERËSIMIT: ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I INSTITUCIONIT....13

2. FUSHA E VLERËSIMIT: BURIMET....24

3. FUSHA E VLERËSIMIT: KURRIKULA....35

4. FUSHA E VLERËSIMIT: MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KËRKIMI....43

5. FUSHAT E VLERËSIMIT: STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE....51

Përfundimet dhe vlerësimi përgjithshëm....60

Lista e evidencave mbështetëse të IAL-së....62

**Shkurtimet**

| | |
|---|---|
| **ASCAL** | Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë |
| **GVB** | Grupi i Vlerësimit të Brendshëm |
| **GVJ** | Grupi i Vlerësimit të Jashtëm |
| **LAL** | Ligji për Arsimin e Lartë |
| **MASR** | Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë |
| **NJSBC** | Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë |
| **UGJ** | Universiteti i Gjirokastrës "Eqrem Çabej" |
| **ILP** | Instituti i Lartë Pedagogjik |
| **BUGJ** | Biblioteka e Universitetit të Gjirokastrës |
| **AMS** | ASCALManagment System |
| **FESHSH** | Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore |
| **FSHN** | Fakulteti i Shkencave të Natyrës |
| **FE** | Fakulteti Ekonomik |



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

## Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit

Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër vjen në procesin e akreditimit institucional pas një eksperince të suksesshme tre vjet më parë, ku Institucioni me Vendim Nr.67 datë 21.09.2017 u akreditua për një periudhë kohore tre vjeçare nga Bordi i Akreditimit i ASCAL. Procesi i akreditimit është në vazhdimësi të kësaj eksperince dhe synon plotësimin e standardeve të cilësisë nga UGJ, punë që ka vazhduar intensivisht pas procesit të akreditimit institucional të kaluar duke patur paraysh çdo rekomandim të GVJ dhe duke përmirësuar çdo dobësi të evidentuar prej tyre.

Raporti i vlerësimit të brendshëm të UGJ është hartuar në përputhje me kriteret dhe standardet e parashikuara në "*Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë*", për të monitoruar zbatimin e standardeve shtetërore të cilësisë, mbi rekomandimet e lëna nga GVJ gjatë procesit të parë të akreditimit dhe mbi standardet e cilësisë të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, me qëllim një funksionim të suksesshëm për të arritur rezultate të kënaqshme.

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm është ngritur nën përgjegjësinë e titullarit të institucionit, rektorit Prof.Dr.Bektash Mema, me Urdhër nr. 06, datë 16.02.2021, bazuar në vendimin e Senatit Akademik Nr.38 datë 09.12.2020, në mbështetje të nenit 103 të Ligjit Nr.80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", Statutit të UGJ-së, si dhe në "*Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë*" .

Në ngritjen e GVB-së dhe në përzgjedhjen e anëtarëve të tij, Rektorati mori parasysh eksperiencën e mëparshme të kandidatëve si dhe rezultatet e kënaqshme të punës së këtij grupi. Në përbërjen e GVB-së u pa e arsyeshme të ishin pjesëmarrës dhe zëvendës rektorët e institucionit për të lehtësuar punën dhe ndihmuar në koordinimin me njësitë, drejtoritë dhe sektorët e UGJ-së. GVB-ja në përbërjen e tij ka përfaqësues nga të tre fakultetet e Institucionit dhe përfaqësues nga studentët. Nga momenti i ngritjes së tij e në vazhdim anëtarët e grupit, janë koordinuar duke bashkërenduar punën ndërmjet tyre.

Për të monitoruar zbatimin e standardeve të cilësisë u hartua raporti i vlerësimit të brendshëm në përputhje me kriteret dhe standardet e parashikuara.

*Për hartimin e raportit u ndoqën këto faza:*

a. Grupi i punës bëri një ndarje të detyrave, sipas fushave përkatëse për çdo anëtar. Kjo ndarje nuk ishte shteruese pasi çdo fushë dhe çdo dokument i administruar diskutohej së bashku nga të gjithë anëtarët, në mbledhjet periodike të grupit të vlerësimit të brendshëm.



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

b. Fillimisht u studiuan standardet e zyrtare të cilësisë dhe kriteret përcaktues të këtyre standardeve për çdo fushë.

c. Grupi i punës organizoi takime me njësitë, përgjegjësat dhe sektorët përkatës, me qëllim mbledhjen e informacionit të nevojshëm nga çdo strukturë dhe për çdo fushë.

d. Mbledhja e dokumentacionit dhe diskutimi i çdo dokumenti të administruar nga të gjithë anëtarët e grupit të punës.

e. Hartimi i pjesës narrative të raportit duke përputhur çdo kriter të kërkuar me evidencat përkatëse që ilustrojnë përmbushjen e tij.

**Etapat e proçedurës së vlerësimit të brendshëm nga IAL:**

- ✓ Kërkesë për fillimin e procesit të vlerësimit të jashtëm institucional nga ana e Universitetit të Gjirokastrës "Eqrem Çabej ". Nr.561/1 Prot Datë 28.05.2020
- ✓ Pranimi i kërkesës nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë. Nr 131/1 Prot, Datë 06.10.2020
- ✓ Ngritja e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm nga titullari i IAL-së.Nr 99 Datë 11.12.2020
- ✓ Kryerja e vlerësimit të brendshëm sipas udhëzimeve të ASCAL.
- ✓ Përgatitja e dosjes së vetëvlerësimit.
- ✓ Hartimi i Raportit të Vetëvlerësimit të Brendshëm (RVB) sipas kërkesave, udhëzimeve si dhe ligjeve në fuqi.
- ✓ Konsultimi i draftit me stafin akademik në UGJ dhe grupet e interesit në një takim të hapur. Miratimi nga Senati Akademik i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm
- ✓ Dorëzimi i Raportit të Vetëvlerësimit të Brendshëm (RVB) në ASCAL së bashku me dokumentacionin shoqërues të printuar dhe në format elektronik.

Në kuadër të rekomandimeve të Bordit të Akreditimit (Vendim Nr.67, datë 21.09.2017), për akreditimin e parë institucional, UGJ gjatë periudhës 3-vjeçare (2017-2020), ndërmori një sërë masash për përmbushjen e tyre.

**Për rekomandimin nr. 1**, UGJ ka filluar një metodë më efektive në monitorimin e të diplomuarve të vet dhe paralelisht ka zhvilluar takime me grupet lokale të interesit.

**Për rekomandimin nr.2**, UGJ ka ndërmarrë një sërë masash për inkurajimin dhe përdorimin nga ana e stafit akademik të TIK në programet mësimore dhe aktualisht kjo është bërë funksionale dhe me përdorimin e platformës MICROSOFT TEAMS dhe licensimit zyrtar të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

paketës MICROSOFT 360, të aksesueshme nga secili anëtar i stafit akademik, ndihmës akademik dhe studentët.

**Për rekomandimin nr. 3**, UGJ ka ndërmarrë masat e duhura për krijimin e një strategjie të kërkimit shkencor me standarte të universiteteve më të mira europiane, e cila është duke u përmirësuar nëpërmjet pjesëmarrjes në një projekt KA2 të programit Erasmus Plus.

*Të gjitha këto prezantohen në detaje tek materiali në vijim:*



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

# I. Historiku i IAL

Universiteti "Eqrem Çabej" i Gjirokastrës u krijua me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 414, datë 12 Nëntor 1991, mbi bazën e Institutit të Lartë Pedagogjik, që ishte çelur më 1971. Ai është institucioni më i rëndësishëm arsimor, shkencor e kulturor i Rajonit Jugor të Shqipërisë.

Arsimi i lartë në Gjirokastër, deri në themelimin në themelimin e Universitetit ka patur një traditë dhe përvojë të konsiderueshme. Më 1968 hapet Filiali i Fakultetit Ekonomik (pa shkëputje nga puna) të Universitetit të Tiranës, i cili vazhdoi për 11 vjet.

Një vit më vonë (1969) hapet edhe Filial i Institutit të Lartë Bujqësor (dega e Agronomisë), i cili vazhdoi për 10 vjet. Po në këtë vit (1969) u hap gjithashtu Instituti Pedagogjik 2-vjeçar pa shkëputje nga puna për përgatitjen e mësuesve për specialitete të tilla si Gjuhë - Letërsi, Histori – Gjeografi, Biologji - Kimi, Matematikë - Fizikë. Gjithashtu, po në këtë vit u hap dhe funksionoi për 5 vjet, Filiali i Institutit të Kulturës Fizike "Vojo Kushi".

Mbi bazën e kësaj përvoje në vitin 1971, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 4 date 08.01.1971, fillon veprimtarinë e tij Instituti i Lartë Pedagogjik 3-vjeçar me shkëputje nga puna, në fillim me degët Histori-Gjeografi dhe Matematikë-Fizikë.

Në 1980 hapet dega e Biologji-Kimisë.

Në vitin 1991 Instituti i Lartë Pedagogjik 3-vjeçar, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 414 date 12.11.1991, shndërrohet në Institut të Lartë Pedagogjik 4-vjeçar. Po në këtë vit (1991) çelet dhe dega e përgatitjes së mësuesve të Cikli i Ulët dhe me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 255, datë 24.07.1986 u hap dega e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Për një periudhë prej 10 vjetësh, Instituti i Lartë Pedagogjik 4 - vjeçar u kompletua me të gjitha profilet e përgatitjes së mësuesve, u konsolidua, u pasurua me bazë të nevojshme materialo-mësimore. U ndërtua korpusi i ri me të gjitha mjediset e nevojshme për mësim si dhe godina e konviktit. Nga viti në vit u rrit shkalla e kualifikimit të pedagogëve.

Në vitin akademik 1993-1994, me Vendim të Këshillit të Ministrave përkatësisht Nr. 435, datë 03.09.1993, dhe Nr. 300, datë 21.06.1994, Universiteti i Gjirokastrës u zgjerua me hapjen e dy degëve të reja, përkatësisht të degës së Gjuhës e Letërsisë Greke, e cila përgatit mësues për shkollat e minoritetit grek dhe asaj të Gjuhës Angleze.

Në vitet në vazhdim Universiteti i Gjirokastrës plotësohet edhe me programe të tjera studimi të Ciklit të Parë, jashtë profilit të mësuesisë, si Kontabilitet-Financë, Administrim Publik, Turizëm, Infermieri e Lartë, Infermieri Mami, si dhe me programe studimi të Ciklit të Dytë "Master profesional" dhe "Master i shkencave" dhe të Ciklit të Tretë "Doktoraturë".



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

Në përgjithësi kontigjenti i studentëve të UGJ-së është nga rrethet e Shqipërisë së Jugut. Gjithashtu ka patur ndër vite edhe studentë nga territoret shqiptare jashtë kufijve të Shqipërisë, nga Kosova, Republika e Maqedonisë të Veriut, Mal i Zi, por edhe studentë të huaj, nga Greqia, Turqia, Polonia, etj.

Ndërkaq sot është zgjeruar harta gjeografike e regjistrimit të studentëve. Kemi kontigjente që vijnë edhe nga Shqipëria e Mesme, madje edhe nga rajonet veriore.

Pranimi i studentëve pas vitit 1990 deri në vitin 2005 bëhej mbi bazën e konkursit të organizuar nga vetë universiteti, kurse nga viti 2006 e në vazhdim pranimi i studentëve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë bëhet mbi bazën e "Maturës Shtetërore", kurse në programet e studimit të ciklit të dytë "Master i shkencave" dhe "Master profesional", pranimi i studentëve bëhet mbi bazën e kritereve që përcakton vetë Universiteti. Studentët mund të ndjekin studimet në formën e studimit me kohë të plotë dhe kohe te zgjatur ne baze te nenit 69 te ligjit 80/2015 per Arsimin e Larte dhe Kërkimin Shkencor.

Nga viti 1994 e në vazhdim, Universiteti "Eqrem Çabej" filloi funksionimin mbi bazën e departamenteve (u suprimuan katedrat). Sipas Vendimit të Ministrisë së Arsimit Nr. 128, datë 27.10.1994, filluan të funksionojnë tre fakultete dhe 10 departamente (Fakulteti i Shkencave të natyrës, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Fakulteti i Edukimit).

**Me vendim Nr. 823**, datë 05.12.2007 të Këshillit të Ministrave, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Fakulteti i Edukimit bashkohen dhe krijohet Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore.

**Me Urdhër të MASR Nr 126** datë 20.03.2017 krijohet Fakulteti Ekonomik.

Aktualisht Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër ka në përbërje tre njësi kryesore:

***Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore***

Në këtë fakultet funksionojnë 6 njësi bazë.

***Fakulteti i Shkencave Natyrore.***

Në përbërje të këtij fakulteti janë 3 njësi bazë.

***Fakulteti Ekonomik***

Në përbërje të këtij fakulteti janë 3 njësi bazë.

*Në mënyrë të detajuar:*

1. Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, me programe studimi të ciklit të parë Bachelor, Master, Master profesional, Master i shkencave dhe Doktoraturë në fushat e kërkimit të tij: gjuhë shqipe, arsim fillor, arsim parashkollor, letërsi shqipe, gjuhë të huaj (anglisht, italisht, greqisht), histori, gjeografi, albanologji, programe me karakter profesional 2-vjeçare në librar dhe bibliotekar, udhërrëfyes turistik dhe edukatorë për zhvillimin e fëmijërisë së hershme.

2. Fakulteti i Shkencave të Natyrës, me programe studimi Bachelor dhe Master profesional në fushat e kërkimit të tij: biologji, kimi, matematikë, fizikë, teknologji e informacionit, informatikë, infermieri e përgjithshme, infermieri mami dhe shkenca infermierore.

3. Fakulteti Ekonomik, me programe studimi Bachelor, Master profesional në fushat e kërkimit të tij: administrim publik, financë, kontabilitet, turizëm, si dhe programet 2-vjeçare në ndihmës ekonomist, asistent administrativ dhe asistent menaxher në shërbimet turistike.

| |
|---|
| **I. FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE** |
| **DEPARTAMENTET/ NJËSITË BAZË** |
| 1. Departamenti / Njësia bazë e Gjuhës shqipe |
| 2. Departamenti / Njësia bazë e Letërsisë Shqipe |
| 3. Departamenti / Njësia bazë e Historisë dhe Gjeografisë |
| 4. Departamenti / Njësia bazë e Edukimit dhe të Metodologjisë së Mësimdhënies |
| 5. Departamenti / Njësia bazë e Gjuhëve të Huaja |
| 6. Departamenti / Njësia bazë e Gjuhës, Letërsisë dhe Qytetërimit Grek |
| **II. FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS** |
| **DEPARTAMENTET/ NJËSITË BAZË** |
| 1. Departamenti / Njësia bazë e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës |
| 2. Departamenti / Njësia bazë e Biologji-Kimisë |
| 3. Departamenti / Njësia bazë e Infermierisë |
| **III. FAKULTETI EKONOMIK** |
| **DEPARTAMENTET/NJËSITË BAZË** |
| 1. Departamenti / Njësia bazë e Kontabilitet - Financës |
| 2. Departamenti / Njësia bazë e Administrimit Publik |
| 3. Departamenti / Njësia bazë e Politikave Ekonomike dhe Turizmit |

Aktualisht Universiteti i Gjirokastrës është i kompletuar me tre ciklet e studimit:

a. Programet e ciklit të parë të studimeve "Bachelor", ku përfshihen **18** programe studimi me kohë të plotë.

b. Programet e ciklit të dytë të studimeve "Master", "Master profesional" dhe "Master i shkencave", ku përfshihen **8** programe studimi "Master", 7 programe studimi "Master profesional" dhe **5** programe studimi "Master i shkencave", me kohë të plotë.

c. Programet e ciklit të tretë të studimeve, "Doktoraturë në Albanologji".

d. UGJ ofron edhe **6** programe studimi me karakter profesional 2-vjeçare, me kohë të plotë.

Mbi bazën e përvojës dhe arritjeve të deri tanishme, Universiteti ka kryer disa studime që kanë lidhje me zhvillimin e tij në të ardhmen, qoftë në drejtim të ristrukturimit, aq ashtu edhe në atë të zgjerimit me programe studimi e veprimtari të tjera.

Një nga objektivat e riorganizimit përfshin edhe hapjen e programeve duale me universitete të huaja, në fushën e trashëgimisë kulturore. Me qëllimin, për t'u përshtatur me kërkesat e *Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"*, UGJ vazhdon përpjekjet e tij për hapjen e këtyre programeve, sipas standarteve përkatëse dhe legjislacionit në fuqi.

Të gjitha programet e studimit dhe kurrikulat e tyre janë të riorganizuara, me qëllim përshtatjen e tyre në përputhje me ligjin e arsimit të lartë 80/2015 dhe aktet e reja nën ligjore në fuqi.

Që nga themelimi i UGJ-së (1991) e në vijimësi punohet për krijimin e strukturave dhe institucioneve ndihmëse për procesin mësimor dhe veprimtarinë kërkimore-shkencore. Universiteti është i pajisur me laboratorë, kabinete me rrjetin bashkëkohor të internetit dhe një bibliotekë shkencore. Gjithashtu Universiteti është edhe qendër e rëndësishme kërkimore, shkencore dhe botuese.

UGJ-ja në funksion dhe shërbim të veprimtarisë akademike e kerkimore shkencore si dhe ngritjes së kapaciteteve tw institucionit ka ndërtuar një bashkëpunim të gjërë me të gjitha universitetet e tjera të vendit si dhe ka nënshkruar protokolle të bashkëpunimit me shumë universitete perëndimore. Në kuadrin e bashkëpunimit ndërinstitucional me universitetet e tjera shqiptare, një rol të rëndësishëm luan pjesëmarrja dhe bashkëpunimi në Konferencën e Rektorëve.

Politika e ndërkombëtarizimit ka patur një shtrirje të gjerë mes personelit të UGJ-së. Kjo ka mundësuar shkëmbime të personelit me universitetet partnere si dhe ka nxitur e [illegible] në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

rritjen e kapaciteteve, në kuadër të projekteve për ngritjen e kapaciteteve të Bashkimit Europian. Kjo ka sjellë për rrjedhojë realizimin e një sërë aktivitetesh ndërkombëtare në UGJ.

Universiteti i Gjirokastrës është anëtar në shumë shoqata ndërkombëtare. Anëtarësimi në këto shoqata ndihmon gjithashtu pedagogët për të marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare, projekte të përbashkëta, botim artikujsh në revista shkencore të universiteteve me të cilët Universiteti ka bashkëpunim.

Universiteti i Gjirokastrës është përfshirë në shumë programe bashkëpunimi në kuadrin e projekteve europiane "ERASMUS PLUS", "IPA INTERREG CBC Greqi–Shqipëri 2014-2020" etj. Bursat individuale, që kanë përfituar pedagogët në kuadrin e programeve KA1 ERASMUS PLUS kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e kualifikimit, përvojës së tyre pedagogjiko – shkencore si dhe në krijimin e kontakteve me mjaft pedagogë të universiteteve të vendeve të tjera.

## II. Misioni

UGJ ka për mision të transmetojë, zhvillojë, gjenerojë dije përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. UGJ ka në fokus formimin profesional të specialistëve të lartë në fushat që mbulojnë të gjitha programet e studimit (mësues për AMU, infermierë të përgjithshëm dhe infermierë mami, specialistë të ekonomisë, specialistë të teknologjise së informacionit), trajnimin dhe kualifikimin e vazhdueshëm në mënyrë që çdokush të maksimalizojë pritshmëritë e perspektivës individuale dhe njëkohësisht të jetë i aftë t'u përgjigjet sfidave të zhvillimit kombëtar.

Gjithashtu UGJ ka për mision të shërbejë si një qendër e rëndësishme kërkimore-shkencore- botuese, në bashkërendim me Programet Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit si dhe me Politikat Sektoriale të Zhvillimit.

## III. Vizioni

Ugj synon të identifikohet si një qëndër e rëndësishme referimi rajonal e kombëtare në kooperimin akademik universitar, në kërkimin shkencor, aktivitetin botues, promovimin e vlerave të arsimit të lartë; edukimin dhe përgatitjen e profesionisteve që mbulojnë sektorët strategjikë të zhvillimit rajonal dhe kombëtar shqiptar. UGJ synon të rrisë cilësinë e kërkimit duke e orientuar me fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit (referuar Ligjit Nr.80 / 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë").

Gjithashtu UGJ synon të ofrojë diploma të përbashkëta me universitetet parnere, në kuadrin e marrëveshjeve dhe programeve të studimit me interes të përbashkët.

Universiteti synon t'i përshtatet dhe paraprijë zhvillimit shoqëror e ekonomik me fokus parësor rajonin jugor dhe atë ndërkufitar. Ngritja e qëndrës ndërdisiplinore e kërkim-zhvillimit me fusha prioritare turizmin kulturor, agroturizmin, ekoturizmin etj, do të rrisë kontributin e UGJ në zhvillimin e qëndrueshëm të Rajonit.

## 1. FUSHA E VLERËSIMIT: ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I INSTITUCIONIT

| Autonomia |
|---|
| **Institucioni dhe strukturat e tij funksionojnë në përputhje me statutin e institucionit.***(Kreu III Standardi I.1)*<br>Dokumenti kryesor i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër (UGJ) është Statuti i cili është në përputhje me Ligjin e Arsimit të Larte 80/2015 [E1.1], i miratuar nga Senati Akademik (SA) [E1.2], Këshilli i Administrimit (KA) [E1.3] dhe nga MASR. UGJ funksionon sipas Statutit dhe rregulloreve të brendshme të UGJ-së [E1.4]. Rregullorja e UGJ është përditësuar në përputhje me aktet nënligjore dhe, sipas përcaktimit në statutin e UGJ, është miratuar në Senatin Akademik të UGJ -së [E1.5].<br>Fakultetet dhe Departamentet e UGJ funksionojnë në përputhje me Statutin e UGJ-së, si dhe në bazë të rregulloreve të tyre të brendshme të miratuara në njësitë përkatëse (kryesore e bazë) [E1.6.-E1.8] [E1.9-E1.11] dhe rregullores së brendshme të UGJ-së. [E1.6.1-E1.8.1]. |
| **Institucioni organizohet në mënyrë të tillë që të sigurojë efiçiencë në menaxhim.** *(Kreu III Standardi I.2)*<br>Institucioni menaxhohet nga organet dhe autoritetet drejtuese të UGJ (akademike e administrative), të përcaktuara në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe statutin e rregulloren e brendshme të UGJ. UGJ gëzon liri akademike dhe autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit. Organet kryesore drejtuese të UGJ janë SA, BA, Rektorati, Dekanati, Këshilli i Etikës dhe Komisionet e Përhershme. Të gjitha kompetencat dhe detyrimet e organeve drejtuese janë të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë si dhe në Statutin dhe rregulloren e UGJ [E1.1]. Në Statutin e UGJ [E1.1] përcaktohen funksionet e SA: garanton autonominë e UGJ; propozon planin strategjik të zhvillimit (i cili i përcillet BA për miratim); miraton statutin (pas miratimit paraprak në BA) dhe rregulloret; harton strukturën e përgjithshme të UGJ dhe i propozon BA numrin e personeli në të gjitha nivelet; miraton hapjen, riorganizimin apo mbylljen e njësive dhe programeve të studimit; miraton raportin vjetor të veprimtarisë së UGJ; miraton krijimin e komisioneve përhershme; garanton sigurimin e brendshëm të cilësisë; miraton planin buxhetor vjetor e afatmesëm dhe ia përcjell BA për miratim. SA mblidhet periodikisht për të diskutuar çështje të rëndësishme institucionale që kanë të bëjnë me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe/ose çështje organizative, administrative e financiare. SA ka rregulloren e brendshme të funksionimit [E1.12], në të cilën përcaktohen të gjitha procedurat për përgatitjen dhe zhvillimin e |

mbledhjeve, për mbajtjen e dokumentacionit, për vendimet dhe zbardhjet e tyre. Gjatë 3 viteve të fundit, SA ka marrë vendimet e nevojshme në përputhje me prioritetet akademike e administrative të UGJ. Vendimet e SA për mirëfunksionimin e gjithë njësive të UGJ janë parë si faktor për qëndrueshmëri e zhvillim të UGJ. Administratori i UGJ: përgatit/harton projekt buxhetin vjetor mbi bazën e kërkesave të njësive kryesore dhe njësive bazë, të planit strategjik të UGJ, të planit buxhetor afatmesëm; propozon kriteret për administrimin e burimeve financiare e materiale dhe ja paraqet BA për miratim; harton dhe i paraqet për miratim BA dhe SA raportet financiare sipas viteve akademike; bashkëpunon me rektorin për përmbushjen e objektivave të UGJ.

Rektorati: mbështetur në përparësitë e institucionit harton planin strategjik të institucionit bazuar në nevojat dhe propozimet e njësive akademike (bazë dhe kryesore) si dhe ato administrative dhe ja përcjell SA për miratim; formulon kriteret për shpërndarjen e burimeve financiare, materiale dhe njerëzore; paraqet në SA për miratim planin vjetor të veprimtarive akademike dhe kërkimore shkencore, raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së institucionit, propozimet mbi projekt-marrëveshjet, bashkëpunimet apo anëtarësimet e institucionit në organizma apo institucione kombëtare/ndërkombëtare.

Bordi i Aministrimit është organi më i lartë kolegjial Administrativ i cili garanton mbarëvajtjen financiare dhe administrative të UGJ-së [E1.1,]. Kriteret dhe përbërja e BA përcaktohen qartë në ligjin 80/2015, VKM Nr. 782, datë 26.12.2018, Statutin e UGJ dhe Rregulloren e BA [E1.22].

BA: garanton qëndrueshmërinë financiare, miraton planin strategjik, buxhetin vjetor afatmesëm, numrin e personelit, përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij, etj. Në detaje funksionet e BA përcaktohen në Statutin e UGJ dhe Rregulloren e BA [E1.1, E1.22]. Në Satutin e UGJ është e përcaktuar funksionimi i Këshillit të Etikës (KE) [E1.1]. SA ka miratuar anëtarët e rinj të KE [E1.23]. KE promovon dhe shqyrton çështjet që lidhen me etikën në veprimtarinë e UGJ, me iniciativë ose përmes ankesave të ardhura nga struktura brenda dhe jashtë institucionit. KE shprehet me vendim dhe i propozon Rektorit marrjen e masave disiplinore. Funksionimi i UGJ bazohet edhe në Kodin e Etikës [E1.24]. Sipas Urdhërit të MASR me Nr. 8 datë 14.01.2020, KE-s i është shtuar edhe kontrolli antiplagjiaturë dhe verifikimi i ligjshmërisë, i fitimit të gradës shkencore dhe titullit akademik. SA ka miratuar kriteret dhe standartet antiplagjiaturë [E1.25].

Dekanati është organi më i lartë kolegjial në nivel Njësie Kryesore dhe përbëhet nga Dekani (i cili e drejton), zv. Dekani/ët, drejtuesit e Njësive bazë. Sipas Statutit [E1.1] të UGJ paraqiten qartë funksionet e Dekanatit. Atje merren vendime dhe propozime të ndryshme dhe i përcillen Rektorit/Rektoratit/SA. Dekanati diskuton çështje që kanë të bëjnë me programet e studimit, kriteret e pranimit, etj. Dekanati, miraton përparësitë e zhvillimit të njësisë, programet e studimit,

| |
|---|
| kuotat dhe kriteret e pranimit të studentëve; koordinon dhe integron veprimtarinë e njësive bazë; harton dhe miraton paraprakisht rregulloren e brendshme, jep lejen etike për të kryer kërkime shkencore etj. Dekani është autoriteti më i lartë akademik i Njësisë Kryesore dhe përfaqësuesi i saj ligjor [E1.1]. Sipas Rregullores së zgjedhjeve [E1.27], Dekani zgjidhet me votë të fshehtë nga personeli akademik me kohë të plotë i njësisë kryesore dhe studentët në masën 10 % (dhjetë për qind) të totalit të përgjithshëm të votave [E1.27]. Drejtuesi i Njësisë Bazë zgjidhet nga personeli akademik me kohë të plotë i Njësisë Bazë [E1.1, E1.27]. Në bazë të rezultateve të votimeve të zgjedhjeve të 2020 në UGJ, Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ) ka shpallur fituesit [E1.28]. Pas shpalljes së fituesve nga KIZ, janë emëruar autoritetet drejtuese të UGJ [E1.29]. Institucioni, ka hartuar dhe miratuar rregulloren e re të zgjedhjeve [E1.27]. Për arsye të mos përmbushjes së numrit të personelit akademik me titullin Profesor, UGJ nuk ka ngritur ende Këshillin e Profesorëve. |
| **Institucioni favorizon debatin konstruktiv.** *(Kreu III Standard I.3)*<br>SA mblidhet me nismën e kryetarit të tij dhe zhvillon mbledhje periodike, si rregull një herë në muaj. Anëtarët e SA njoftohen nga sekretari për datën dhe rendin e ditës në mënyrë elektronike ose shkresore dhe janë të detyruar të konfirmojnë ose jo pjesëmarrjen e tyre (Rregullore SA). Mbledhja drejtohet nga kryetari i SA dhe vetëm në rast mungese objektive mbledhja thirret dhe drejtohet nga nën-kryetari. SA mund të thirret edhe në seancë të jashtëzakonshme me kërkesën e një të tretës së numrit të anëtarëve [E1.12]. Organizimi i mbledhjeve bëhet nga sekretari i SA, ndërsa rendi i ditës, data e mbledhjes caktohet nga Kryetari. Të gjitha materialet dhe rendi i ditës vihen në dispozicion të anëtarëve, të paktën një ditë para mbledhjes [E1.12]. Vetëm në raste emergjente mund të mos ndiqet kjo procedurë. Kërkesa për çështje të cilat duhet të futen në rendin e ditës duhet të paraqiten të paktën tre ditë para mbledhjes me shkresë (Rregullore e SA). Mbledhja e SA mund të zhvillohet vetëm në rastet kur janë prezent 50% +1 të anëtarëve. Vendimet e SA zbatohen nga Njësitë Bazë dhe Njësitë Kryesore, strukturat ndihmësakademike dhe administrative.<br>Pjesë e debatit konstruktiv janë edhe studentët, të organizuar si: studentë të zgjedhur, përfaqësues në Senat, dhe si studentë përfaqësues, anëtarë në Komisionin e përhershëm të Marrëdhënieve me studentët. |
| **Institucioni respekton kufijtë e autonomisë së tij.** *(Kreu III Standardi I.4)*<br>UGJ i përmbahet kufijve të kësaj autonomisë së përcaktuar me ligj.<br>Autonomia financiare në UGJ, sigurohet nëpërmjet autonomisë për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi, |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| |
|---|
| nëpërmjet përcaktimit të tarifave të studimit, administrimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme në përputhje me misionin e tyre. **(E1.15).** Përveç vetëfinancimit, autonomia financiare sigurohet edhe nëpërmjet përfitimit të fondeve nga shteti **(E1.15.1)** dhe nga organizma të tjerë, që në rastin e UGJ-së, janë projektet e financuara nga BE **(E1.34).** Për momentin UGJ është duke implementuar 11 projekte me financim nga programet europiane e më gjerë) [**E1.34**], pesë (5) projekte ERASMUS+, katër (4) INTERREG IPA Cross Border Shqipëri-Greqi dhe 2 projekte me fonde nga AKKSHI për ngritje laboratorësh në shërbim të procesit mësimor). UGJ ka caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit. **(4.17)**<br>Liria akademike përmban autonominë për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese. **(E.18).** Autonomia akademike e UGJ-së konsiston edhe në autonominë për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore. **(E1.21).** Gjithashtu, në kuadër të autonomisë akademike, UGJ ka organizuar procesin e promovimit të personelit akademik, duke vlerësuar veprimtarinë e tyre. **(E1.38 ).**<br>Autonomia organizative në UGJ, lidhet me autonominë për t'u vetëqeverisur, për të zgjedhur organizmat drejtues, për të organizuar strukturat dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të tyre të brendshme, të hartuara në përputhje me ligjin, aktet nënligjore dhe aktet e brendshme. Zgjedhjet organizohen sipas rregullores përkatëse. **(E1.27 ).** |
| **Institucioni harton një strategji zhvillimi.** *(Kreu III Standardi I.5)*<br>UGJ ka hartuar dhe zbaton strategjinë e zhvillimit të saj. Strategjia e institucionit është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij si institucion i arsimit të lartë, përcaktuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe në Statutin e UGJ-së. Ndër vite UGJ ka ndërtuar një kulturë bashkëpunuese. Të gjitha vendimet që merren nga Organet Kolegjiale dhe autoritetet drejtuese të UGJ diskutohen gjerësisht. Shumë herë dokumente ose çështje të ndryshme diskutohen në disa mbledhje më qëllim përmirësimin e dokumentit deri në arritjen e variantit final. Strategjia e Zhvillimit [E1.33] është një nga dokumentet kryesore për UGJ dhe për këtë arsye hartimi i tij kërkoi një punë shumë të madhe nga Njësitë Bazë dhe Njësitë Kryesore. Fillimisht në nivel Institucioni u ngrit një grup pune me qëllim hartimin e një strategjie Zhvillimi të Institucionit. Kjo strategji zhvillimi u miratua nga SA [E1.33.1]. Mandej u kalua në një fazë më të thelluar duke implementuar modele më të avancuara të zhvillimeve strategjike. Procesi përfshiu të gjitha njësitë kryesore e bazë dhe rezultoi me prodhimin e srategjive të zhvillimit sipas këtyre njësive. Shembuj Plani Strategjik Fakulteti dhe Departamentesh jepen tek [E1.43-1.48] dhe tek https://uogj.edu.al/strategjia-e-zhvillimit/ (FESHSH) dhe https://uogj.edu.al/strategjia-fshn/ (FSHN). Hartimi i këtyre dokumenteve pati për |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

qëllim edhe përfshirjen e të gjithë personelit akademik sipas njësive përkatëse por edhe të grupeve studentore. Aktualisht UGJ ka Strategjinë e Zhvillimit 2020-2025, miratuar nga SA [E1.33.1] Sipas Strategjisë së Zhvillimit [E1.33], UGJ është krijuar për të qenë në shërbim të dijes, edukimit dhe mirëqënies së shoqërisë shqiptare. UGJ synon të mbetet një universitet publik i njohur dhe i kërkuar jo vetëm në territorin e Shqipërisë, por edhe më gjerë, duke u mbështetur fuqishëm në vlerat e tij në mësimdhënie cilësore, kërkim dhe hulumtim profesional, integritet dhe dinjitet social. Strategjia e Zhvillimit e UGJ ka përcaktuar qartë objektivat si dhe skenarët e Zhvillimit për pesë vitet e ardhshme. Për secilin skenar paraqiten linjat strategjike, dhe për çdo linjë strategjike paraqiten metodat dhe mekanizmat për arritjen dhe plotësimin e tyre.

Të gjitha objektivat dhe skenarët janë të paraqitur me detaje tek Strategjia e Zhvillimit. Për çdo skenar, dhe linjë strategjike janë specifikuar veprimet ose më saktë Plani i Veprimit, Instrumentat për arritjen e tyre, afati kohor, përgjegjësitë për ti implementuar, si dhe kostoja e çdo veprimi. Në detaje këto prezantohen tek Strategjia e Zhvillimit

Statuti i UGJ[E1.1] dhe Strategjia e Zhvillimit [E1.66] janë në koherencë dhe synojnë implementimin e misionit dhe qëllimeve të UGJ.

**Institucioni publikon raportin vjetor, e paraqet atë pranë Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe para personelit akademik dhe studentëve.** *(Kreu III Standardi I.6)*

Raporti vjetor i veprimtarisë së institucionit, është dokumenti i cili përmbledh veprimtarinë vjetore akademike dhe veprimtarinë vjetore financiare; ndihmon në vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit, për vetë faktin se përmban një analizë të hollësishme[E1.41]. Dokumenti përfundimtar bazohet në raportet e veprimtarisë akademike të njësive kryesore si dhe njësive të tjera përbërëse të UGJ-së. Dokumenti diskutohet edhe miratohet në mbledhjet e Rektoratit, Senatit dhe Bordit të Administrimit. Dokumenti i dërgohet MASR-së si dhe publikohet në faqen zyrtare të UGJ-së.

## Organizimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë

**Institucioni ngre struktura të përshtatshme për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij.** *(Kreu III Standardi II.1)*

Universiteti "Eqrem Çabej", si institucion i arsimit të lartë ka për mision të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet. Mision i UGJ-së është dhe ofrimi i mundësive të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatëgjithë jetës, integrimi i mësimdhënies me kërkimin shkencor, duke nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë. Në këtë mënyrë, misioni i UGJ-së është të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe social-kulturor në nivel

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

kombëtar dhe rajonal, duke mbështetur prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit.
UGJ, në mbështetje të dispozitave ligjore, është e organizuar në Njësi Kryesore (fakultetet), Njësi Bazë (departamentet) si dhe njësi të tjera ndihmësakademike e administrative. Çdo fakultet ka së paku tri njësi bazë.

Departamentet e UGJ-së, si njësi bazë, kanë në përbërje të tyre të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 janë me grada dhe tituj. Njësitë Kryesore dhe NjësitëBazë i kanë të organizuara kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore në funksion të këtij misioni. Këto njësi kanë laboratorë të dedikuar për IT si dhe laboratorë specifike për të integruar teorinë me praktikën.

UGJ-ja ofron programe studimi të bazuara në kulturën historike tradicionale të UGJ-së dhe në nevojat e tregut të punës, nëpërmjet orientimit drejt një tregu në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të zhvillimit dhe mirëqënies në vend. Programet e studimit ofrojnë praktikën mësimore, e cila realizohet në sajë të bashkëpunimeve të UGJ-së me institucione qendrore dhe vendore kombëtare, IAL apo dhe institucione jashtë vendit.Institucioni ka faqen e tij zyrtare të internetit: www.uogj.edu.al

**Organet drejtuese lehtësojnë vendimmarrjen nëpërmjet favorizimit të debatit në këshillat e institucionit.** *(Kreu III Standardi II.3)*

Në kuadër të vendimmarrjes, organet drejtuese të UGJ-së janë organizuar në nivel Institucional dhe në nivel Njësie Kryesore. Anëtarët e këtyre organeve janë zgjedhur ose janë emëruar. Organi më i lartë drejtues akademik i UGJ-së është Senati Akademik. Organe të tjera akademike janë asambleja e personelit akademik dhe komisionet e përhershme.

Senati përbëhet nga 21 (njëzet e një) anëtarë. Njësitë Kryesore përfaqësohen në Senat.

Në Senatin Akademik të UGJ-së përfaqësohen edhe studentët, në masën 10% (dhjetë për qind).

Organi më i lartë drejtues administrativ është Bordi i Administrimit. Ky organ është përgjegjës për garantimin e përmbushjes së misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.

Organe kolegjiale të tjera, në nivel institucional (UGJ) janë: Rektorati dhe Këshilli i Etikës

Rektorati UGJ-së është organ kolegjial që drejtohet nga rektori dhe përbëhet nga: rektori, zëvendësrektorët,administratori i institucionit, drejtuesit e njësive kryesore (Dekanët). Rektorati mblidhet në mënyrë periodike. Funksionet e Rektoratit janë përcaktuar në Statutin e UGJ-së dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tij janë përcaktuar në rregulloren e UGJ-së.

Këshilli i Etikës i UGJ-së, është organ kolegjial vendimmarrës, i cili promovon dhe shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor dhe atij kërkimor, cënimin e integritetit dhe interesave institucionale, si dhe me veprimtaritë e tjera institucionale. Këshilli i Etikës shqyrton dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

merr vendim në lidhje meveprimtari të personelit akademik dhe atij ndihmësakademik nëse përbëjnë shkelje të etikës ose jo. Këshilli i Etikës përbëhet nga 3 (tre) anëtarë që janë përfaqësues nga secila njësi kryesore, të cilët vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik me shumicë të thjeshtë votash. Këshilli i Etikës e kryen veprimtarinë e tij në përputhje me aktet ligjore, nënligjore në fuqi si dhe në bazë të akteve të brendshme të UGJ-së.

Organ kolegjial në nivel njësie kryesore: Dekanati është organ kolegjial që drejtohet nga dekani dhe përbëhet nga: dekani, zëvendësdekani/ët, drejtuesit e njësive bazë. Dekanati mblidhet në mënyrë periodike. Dekanati kryen veprimtarinë e tij në përputhje me aktet ligjore, nënligjore në fuqi si dhe në bazë të akteve të brendshme të UGJ-së.

Komisionet e përhershme janë organe kolegjiale të cilat kryejnë funksione në fushat e përcaktuara në statut [E1.1,].

UGJ me vendimin e SA ka miratuar krijimin dhe funksionimin e komisioneve të përhershme [E1.54]. Komisionet e miratuara janë:

1) Komisioni i Kualifikimit Shkencor dhe Promovimit Akademik,
2) Komisioni i marrëdhënieve me studentët;
3) Komisioni i garantimit të Standarteve të Cilësisë të Institucionit dhe programeve të studimit.

## Partneriteti

**Institucioni kryen studimin e tregut për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij.** *(Kreu III Standardi III.1)*

Institucioni përfshihet në aktivitete shkencore, social-ekonomike, si konferenca dhe simpoziume kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat krijojnë mundësinë për t'u njohur në mënyrë të vazhdueshme me zhvillimin rajonal ekonomik, shoqëror dhe arsimor dhe për të reflektuar në lidhje me përshtatjen e kurrikulave me realitetin e tregut të punës.

Institucioni ka praktika të monitorimit të punësimit të të diplomuarve të vet, nëpërmjet ruajtjes së kontakteve me studentët e diplomuar dhe nëpërmjet krijimit të një database në nivel institucional, për të parë se sa përputhet formimi që ata marrin në këtë institucion me kërkesat e tregut të punës. Ky monitorim realizohet nga Sektori i Shërbimeve Bibliotekare, Arkivore dhe Studentore (zyra e Këshillimit të Karrieres dhe ALUMNIT ), që është strukturë e personelit ndihmësakademik me karakter administrativ, në nivel institucioni[E.1.14]. UGJ mbledh informacione rreth problemeve që hasin të diplomuarit për gjetjen e punësimit të përshtatshëm në vend, në mënyrë që të përmirësojë kurrikulat dhe të ofrojë programe studimi sipas kërkesave të tregut. Në vijimësi punohet që të kemi informacione dhe database më të plotë për këtë proces, si pjesë sistematike e veprimtarisë së UGJ-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| |
|---|
| UGJ respekton rregullat e konkurrencës së lirë dhe të ndershme në treg, duke e bazuar marketingun e tij në prioritetet dhe veçoritë që kanë programet bashkëkohore të studimit që ofron, në përputhjen e programeve të ofruara me kërkesat e tregut të punës dhe në stafin e përgatitur dhe të kualifikuar, si një nga anët më të forta të tij. Në propozimet e bëra për hapjen e programeve të reja të studimit, nga UGJ janë bërë studime të tregut të punës, ku është studiuar nevoja e tregut të punës për specialistë të fushave të ndryshme. |
| **Institucioni ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtare***(Kreu III Standardi III.2)*<br>Institucioni ka të përcaktuara qartë, në strategjinë e zhvillimit të tij institucional, prioritetet e politikës së tij të bashkëpunimit. Këto prioritete reflektohen në marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe me institucione lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare.<br>Nëpërmjet ngritjes së strukturave të posaçme në Rektoratin e UGJ, administrohet procesi për realizimin e objektivave të ndërkombëtarizimit. Institucioni ka zhvilluar partneritet me institucione të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit [E1.35]. Këto partneritete kanë sjellë si produkte organizmin e aktiviteteve të rëndësishme të përbashkëta si konferenca kombëtare e ndërkombëtare, aktivitete ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë së IAL-ve, organizmin e aktiviteteve promovuese të mobiliteteve Erasmus+, trajnime e kualifikime të vazhduara për studentët etj[E1.36].<br>Këto partneritete kanë rrijetëzuar bashkëpunimin në kuadër të projekteve për ngritjen e kapaciteteve, në të cilat UGJ është pjesë [E1.34]. Institucioni është vizituar nga delegacione të ndryshme të universiteteve partnere, njësi përfaqësuese diplomatike, të cilët kanë qenë iniciatorë të projekteve të reja studimore dhe projekteve të infrastrukturës.<br>Partnerë të UGJ-së janë edhe institucione publike qëndrore e vendore [E1.62]. Këto partneritete janë kryesisht të orientuara drejt ofrimit të praktikave mësimore, në të gjitha programet e studimit, për studentët e UGJ-së si dhe organizimit të leksioneve të hapura me tema dhe problematika aktuale, ku dhe studentët kanë luajtur kanë qënë faktorë. Të gjitha këto aktivitete publikohen në faqen web të institucionit,http://uogj.edu.al/gjithe-aktivitetet/ |
| **Institucioni ndjek një strategji bashkëpunimi me institucionet të tjera mbështetëse**. *(Kreu III Standardi III.3)*<br>Institucioni bashkëpunon me shumë Institucione të ndryshme për ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve. Në bashkëpunim me Postën Shqiptare ofron kartën e studentit, ndërsa Bashkia ofron shërbimet e saj falas për studentët dhe mbështetje për organizimin e aktiviteteve të ndryshme si ceremonia e diplomimit, aktivitete sportive etj |



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

Me qëllim finalizimin e studimeve në UGJ, studentët janë të detyruar të kryejnë praktika mësimore. Për këtë arsye, UGJ bashkëpunon me Institucione të shumta si Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyra Arsimore, Spitalin Rajonal te Gjirokastrës, Bankat e nivelit të dytë, Gjykatën, Qarkun e Gjirokastrës, Dhomën e Tregëtisë, Drejtorinë Rajonale të Punësimit etj [E1.62].

UGJ bashkëpunon me partnerë të tjerë për plotësimin e nevojave të veta, në funksion të realizimit të programeve të studimeve, si për shembull Ambasada e SHBA-së, nëpërmjet programeve Fulbright dhe ELF (English Language Fellows).

**Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar.** *(Kreu III Standardi III.4)*

UGJ ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve. Politika favorizuese ndiqet edhe me personelin akademik të huaj dhe studentët, të cilët vijnë në UGJ. Procedura e shpalljes së thirrjes, aplikimit dhe përzgjedhjes është publike . Këto mobilitete ofrohen nëpërmjet: ***Organizimit të mobiliteteve ERASMUS+ outgoing*** (nga UGJ drejt institucioneve partnere) në kuadër të partneriteteve me universitetet partnere, procedura dhe modalitetet e së cilës rregullohen në mënyrë të veçantë. (E1.38 dhe E 1.39). Periudha e mobilitetit të studentëve, i nënshtrohet procedurës së njohjes dhe transferimit të krediteve.

***Organizimit të mobiliteteve ERASMUS+ incoming*** ( nga universitetet partnere në UGJ), ku studentëve dhe personelit akademik u ofrohet informacion dhe asistencë e nevojshme. Në funksion të këtij qëllimi UGJ mbështetet në Guidën Erasmus+ [E1.65], në gjuhën angleze dhe prezanton të gjitha hapat nga momenti që një student i huaj do zgjedhi UGJ për të ndjekur një periudhë të shkurtër studimet e veta, deri në momentin që ai do largohet. Detaje ofrohen për opsionet e ndryshme se si do të vijë në UGJ, proçedurat për marrjen e lejes së qëndrimit, akomodimin etj. Hapat e përmendura më lart janë politikat bazë që UGJ ka hartuar dhe po implementon për integrimin e studentëve të huaj. Gjatë gjithë periudhës që studentët e huaj frekuentojnë leksione në UGJ, Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë komunikon me ta dhe i asiston në çdo problematikë që ata hasin.

UGJ ka hartuar *Rregulloren për Implementimin e marrëveshjeve ndërinstitucionale në kuadër të programit Erasmus+ KA107 International Credit Mobility* [E1.64]. Për këtë arsye ka nënshkruar 36 marrëveshje KA1 për mobilitete të shkurtra për stafin akademik, ndihmës akademik dhe studentët [E1.36]. Nga këto marrëveshje, nga viti 2017 deri më sot kanë përfituar mobilitete afatshkurtra me financim Europian 27 studentë, 67 pedagogë dhe 2 personel ndihmësakademik/administrativ të UGJ [E1.37, E1.38, E1.39]. Paralelisht me hartimin e kësaj rregulloreje, UGJ ka asistuar dhe ka inkurajuar stafin e vet akademik për të kryer ~~vitin~~ Sabatik [E2.30].



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

UGJ fton pedagogë nga Universitete të tjera të Shqipërisë ose të rajonit. Listë e detajuar e pedagogëve të ftuar paraqitet tek Evidencat [E1.53]. Në kuadër të marrëveshjeve KA1, tre vitet e fundit 63 pedagogë të huaj kanë vizituar Institucionin dhe kanë zhvilluar aktivitete mësimore edhe/ose kërkimore [E1.38].

**Përfundimi dhe Vlerësimi**

UGJ ka punuar maksimalisht jo vetëm për të plotësuar mangësitë/dobësitë/rekomandimet e GVJ në procesin e kaluar të akreditimit institucional, por edhe për të aplikuar praktika efikase në bazë të eksperiencave europiane. Hartimi dhe zhvillimi i një Strategjie të re të Kërkimit Shkencor për bashkëpunimin dhe ndërkombëtarizimin e UGJ-së me rritjen e mobiliteteve dhe numrin e aplikimeve dhe thithjes së fondeve të huaja, janë vetëm disa nga arritjet e UGJ.

UGJ e ka të garantuar me ligj autonominë e funksionimit dhe lirinë akademike si Institucion i Arsimit të Lartë, bazuar në kuadrin ligjor në fuqi. Të drejtat dhe privilegjet që burojnë nga liria dhe autonomia akademike aplikohen në funksionet kryesore të Institucionit, kryesisht në mësimdhënie dhe kërkim. Në kuadër të autonomisë dhe brenda limiteve të saj, Institucioni dhe strukturat e tij përbërëse e ushtrojnë aktivitetin bazuar në Statutin dhe Rrregulloren e UGJ-së, akte të cilat mbështeten në kuadrin ligjor në fuqi. Strukturimi i brendshëm i institucionit, i përcaktuar në ligj dhe statut, është i tillë që të sigurojë një bashkëpunim të efektshëmnë vendimmarrje dhe menaxhim, duke favorizuar debatin konstruktiv që nga Njësitë Bazë deri në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit.

Veprimtaria e UGJ-së orientohet nga një strategji zhvillimi 2020-2025, e cila përkon me misionin e institucionit, si dhe bëhet transparente për organet shtetërore (MASR) sidhe për personelin akademik e studentët. UGJ merr në konsideratë studimin e tregut për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij.

UGJ ndjek një politikë shumë favorizuese në funksion të zgjerimit dhe përforcimit të marrëdhënieve ndërmjet UGJ-së dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë në rajon dhe më gjerë. UGJ ka arritur të vendosë marrëdhënie të ngushta me IAL-të brenda dhe jashtë vendit. Këto marrëdhënie bashkëpunimi kanë në bazë të tyre kryesisht shkëmbim idesh, stafi dhe studentësh, organizim të konferencave të përbashkëta, angazhim në projekte kërkimore-shkencore të pëbashkëta për ngritje kapacitetesh nëpërmjet Erasmus +, Horizont 2020 etj. Integrimi dhe harmonizimi i kërkesave dhe nevojave të institucionit tonë me ato të institucioneve të tjera, stafit të huaj dhe studentëve, është vendosur në qendër të këtyre politikave favorizuese.

UGJ ka një statut dhe një rregullore, të bazuara në ligjin e ri të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore të tij. Me qëllim përmbushjen e misionit dhe qëllimeve të veta, UGJ është e organizuar në struktura të posaçme me detyra të ndara. Vendimarrja bëhet pas diskutimit dhe debatit

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

konstruktiv të çdo propozimi dhe mendimi. Të gjitha këto i sigurojnë institucionit një menaxhim efikas. Përpjekjet e shumta të UGJ-së për monitorimin sistematik të punësimit të të diplomuarve janë përmirësuar me rezultate të dukshme, por ka ende shumë punë për t'u bërë.

Bazuar mbi analizat dhe evidencat e raportuara në këtë raport, GVB konkludon se *standartet për fushën Organizimi dhe Menaxhimi i Institucionit përmbushen* **Plotësisht.**



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

## 2. FUSHA E VLERËSIMIT: BURIMET

| Menaxhimi i Burimeve Njerëzore |
|---|
| **Institucion ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe të rekruktimit të burimeve njerëzore.** *(Kreu III Standardi IV.1)*<br>Organigrama e plotë e universitetit është e publikuar në faqen zyrtare të tij http://uogj.edu.al/organograma-e-universitetit/sipas pozicioneve përkatëse [E2.2].<br>Krahas punësimit me kohë të plotë, universiteti punëson edhe burime njerëzore me kohë të pjesshme për nevojat e tij institucionale [E2.6, E2.7, E2.8,].<br>Për çdo pozicion të ri që paraqitet, bëhet publikimi i vendeve të lira të punës në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të UGJ-së dhe pastaj procedohet në bazë të neneve të rregullores së UGJ-së [E1.5] dhe rregullores mbi procedurat e punësimit [E2.1] në transparencë të plotë me bazën ligjore.<br>UGJ-ja ndjek politika inkurajuese promovimi të stafit të tij, trajnimi mbi "Hapat dhe Teknikat e Shkrimit të një Projekt Propozimi Cilësor", "Sesione informues nga përfaqësues të zyrës Kombëtare Erasmus + në Shqipëri"<br>Sipas Rregullores së UGJ-së [E1.5], Njësitë Kryesore bazuar në nevojat për realizimin e procesit të mësimdhënies, përcjellin për miratim në Rektorat kërkesat për personel akademik të ftuar, me kontratë me kohë të plotë ose të pjesshme, duke iu përmbajtur numrit të miratuar nga Bordi i Administrimit për këtë kategori punonjësish. Konkurimi për personelin akademik për të dyja kategoritë bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjes. Kandidati duhet të plotësojë së pari kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në Rregulloren e UGJ-së si dhe kritere specifike të përcaktuara në rregulloret e Njësive Kryesore. Përzgjedhja bëhet në përputhje me ligjin 80/2015 të arsimit të lartë (të ndryshuar) dhe statutin e UGJ-së [E1.1].<br>Vendimi i SA,[E2.15] përcakton qartë rregullat dhe procedurat për punësimin e personelit ndihmësakademik dhe hapat respektivë që ndiqen për rekrutim [E1.1,E1.5] që nga shpallja e vendit vakant nga njësia bazë/njësia kryesore/njësi tjetër në nivel institucional, përgatititja e kërkesës, shpallja e konkursit, miratimi i kritereve ose kualifikimeve të kërkuara për vendin vakant, kërkesa që i përcillet njësisë përkatëse për t'u rishqyrtuar, njoftimi i konkursit publik në Web-in e institucionit si dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, afati që u lihet kandidatëve për të aplikuar, ngritja e një komision *ad-hoc* me urdhër të Rektorit për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave, i cili procedon sipas hapave në përputhje me procedurën e punësimit në UGJ-së dhe deri në përzgjedhjen e kandidatit fitues [E2.9]. |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Në politikat e punësimit që ndiqen nga UGJ i jepet përparësi rekrutimit të personelit akademik të kualifikuar në universitet prestigjoze ndërkombëtare

**Institucion ndjek një politikë integruese të personelit akademik, personelit ndihmësakademik mësimor-shkencor dhe personelit administrativ.** *(Kreu III Standardi IV.2)*

UGJ ndjek një politikë integruese të të gjithë të punësuarve të tij me kohë të plotë, të pjesshme, të ftuar apo me kontratë në zbatimin në mënyrë rigoroze dhe korrekte të procedurës së punësimit [E2.1]. Në rregulloren e tij të brendshme janë përcaktuar kriteret dhe procedurat e punësimit dhe kjo gjë zbatohet në përputhje me bazën ligjore. Në kuadër të integrimit të personelit të ri akademik UGJ ka miratuar Kartën dhe Kodin Europian për Kërkuesit, të cilat nxisin dhe integrojnë personelin në politikat dhe trajnimet e UGJ-së për këtë qëllim [E1.18].
Universiteti e angazhon stafin në organizimin e ditëve të hapura [E2.1,E2.13,E2.12] apo atyre të informimit të maturantëve në shkolla të mesme të rajonit dhe më gjerë, për të promovuar UGJ dhe për të tërhequr sa më shumë studentë në programet e studimit të ofruara prej tij. Takimet informuese shoqërohen me mjete informative si broshura, fletëpalosje, postera [E2.11],prezantime në Power Point etj, të cilat shpalosin dhe japin një panoramë të shkurtër të politikave që ndjek universiteti dhe programet e tij të studimit [E2.11]. Më shumë detaje lidhur me këtë gjë, gjenden tek faqja web e UGJ-së. (http://uogj.edu.al/aktivitete-te-universitetit-eqrem-cabej/). UGJ favorizon dhe përkrah gjithashtu edhe integrimin e personelit në jetën sociale të tij, i nxit dhe inkurajon të bëhen pjesë e aktiviteteve të ndryshme me karakter argëtues, informues, letrar, sportiv etj të organizuara nga institucioni, apo nga institucione apo organizma të tjerë në rrethin e Gjirokastrës [E3.42] dhe jo vetëm.

**Institucion ndjek një politikë të vlerësimit të aftësive të personelit të tij.** *(Kreu III Standardi IV.3)*

UGJ ndjek një politikë të vazhduar të vlerësimit të aftësive dhe kualifikimit të personelit të tij. Personeli akademik vlerësohet për performancën në procesin mësimor, tejkalimin e ngarkesës mësimore të parashikuar në fillim të vitit akademik dhe performancën në kërkimin shkencor [E2.14]. Për ngritjen e kapaciteteve UGJ merr pjesë në projektet e BE-së, që i shërbejnë trajnimit, zgjerimit të njohurive dhe aftësive profesionale-akademike, kualifikimit sipas fushave përkatëse të stafit.[E1.34].

**Institucion ndjek një politikë të zhvillimit social.** *(Kreu III Standardi IV.4)*

Politika e zhvillimit social në UGJ, është e fokusuar në aktivitete dhe nisma sociale për studentët dhe për personelin, në përputhje me strategjinë kombëtare përpolitikën e zhvillimit

| |
|---|
| social. Në UGJ, studentët përfitojnë bursë ekonomike si dhe përjashtim nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit, në plotësim të kushteve të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi[E 2.54]. Në UGJ, në bashkëpunim me partnerët vendës dhe të huaj organizohen aktivitete të ndryshme, siç janë aktivitetet e promovimit të librave, sensibilizimit të dhunës ndaj grave, ceremoni mirënjohjeje për figura të rëndësishme, shfaqe teatrale, aktivitete sportive kombëtare e ndërkombëtare e etj. Studentët dhe personeli i UGJ-së është bërë pjesë e nismës kombëtare për të mbështetur me burime njerëzore dhe ndihmë monetare, të prekurit nga tërmeti shkatërrimtar i nëntorit 2019 në Shqipëri. |
| **Institucioni siguron menaxhimin efikas të burimeve njerëzore.***(Kreu III Standardi II.2)*<br>Në statutin e UGJ-së janë përcaktuar qartë funksionet dhe hierarkia e burimeve njerëzore të rekrutuara. Ai siguron një menaxhim efikas të burimeve njerëzore për caktimin e përgjegjësive sipas funksioneve respektive, duke vlerësuar dhe zbatuar me rigorozitet jo vetëm bazën e tij ligjore[E1.1,E1.5], por edhe kapacitetet njerëzore të rekrutuara. Çdo anëtar i personelit është i pozicionuar në varësi të funksionit dhe qëllimit të rekrutimit në UGJ [E 2.1,E2.2]. |
| **Menaxhimi Financiar** |
| **Institucioni harton buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara.***(Kreu III Standardi VI.1)*<br>UGJ i shpërndan dhe i përdor burimet financiare në përputhje me rregullat dhe standartet e programit buxhetor dhe menaxhimit financiar publik [E1.1]. Ai harton projektbuxhetin në varësi të kërkesave dhe propozimeve konkrete që vijnë nga njësitë bazë dhe kryesore [E2.17], si edhe buxhetin afatmesëm, në varësi të rregullave dhe procedurave të vendosura nga Ministria e Financave dhe rregullorja e BA [E2.33]. Hartimi i buxhetit bëhet sipas strukturës së Buxhetit të Shtetit, të përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Financave të Republikës së Shqipërisë. Pas hartimit buxheti i propozuar diskutohet në senat [E2.33] dhe në bordin e administrimit [E2.16] të institucionit. Pas miratimit buxheti i detajuar [E2.34] kalon për menaxhim në zyrën e financës dhe delegohet në varësi të kërkesave apo nevojave të njësive. |
| **Institucioni siguron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën financiare.***(Kreu III Standardi VI.2)*<br>Sipas Statutit, Administratori është përgjegjës për zbatimin e politikës financiare. Nën varësinë e tij janë Drejtoria e Shërbimeve Universitare, i përbërë nga sektori i financë-prokurimeve dhe sektori i shërbimeve. Bordi i Administrimit të UGJ-së që garanton mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij.<br>Drejtoria e Shërbimeve Universitare harton raporte financiare të detajuara [E1.23] dhe zbaton |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

me përpikmëri dhe rigorozitet buxhetin e hartuar [E1.24], duke ndjekur një politikë transparente të shpërndarjes së burimeve financiare, të cilën e publikon rregullisht në faqen e internetit të UGJ http://uogj.edu.al/raport-auditi-dhe-buxheti/)

Gjithashtu, Drejtoria e Shërbimeve Universitare është përgjegjëse për respektimin e rregullave të kontabilitetit në bazë të legjislacionit përkatës në fuqi, në përputhje me kriteret e administrimit financiar të institucioneve të tjera publike[E2.36]. Universiteti analizon të gjithë treguesit e monitorimit të zbatimit të politikave financiare [E2.37]. Në mbledhjet periodike të BA [E2.38,E2.39] analizohen treguesit e zbatimit të politikës financiare, rezultatet e detajuara të të cilave publikohen rregullisht në faqen e internetit të UGJ-së (http://uogj.edu.al/raport-auditi-dhe-buxheti/).

**Institucioni ndjek një politikë të kontrollit buxhetor dhe financiar.***(Kreu III Standardi VI.3)*

Institucioni i nënshtrohet rregullisht auditimit të tij të MASR që kryhet nga sektori i auditit. [E2.38] dhe KLSH-ja.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 116, të Ligjit 80/2015 këto kontrolle janë periodike[E2.38] dhe të gjitha raportet që krijohen pas inspektimeve së bashku me rekomandimet përkatëse diskutohen në mbledhjet me Bordin e Administrimit dhe personelin e UGJ-së. Vendimet e këtyre mbledhjeve bëhen publike dhe në faqen zyrtare të UGJ/së (https://uogj.edu.al/bordi-i-administrimit/).

## Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit

**Institucioni disponon një sistem të informimit.***(Kreu III Standardi VII.1)*

UGJ ka siguruar strukturat përkatëse për zhvillimin dhe përhapjen e informacionit në nivel vertikal, dhe horizontal. Veprimtaria e tyre është përcaktuar në Statutin e UGJ-së [E1.1], në rregulloret dhe aktet e brendshme vetërregulluese.

UGJ disponon një sistem të informimit të mirë organizuar. Ky sistem përbëhet nga sistemi i dhënies së informacionit/kthim përgjigje në mënyrë elektronikedhe nga dhënia e informacionit ngastrukturat ndihmësakademikenë Rektoratin e UGJ-së si dhe pranë njësive kryesore. Informacioni mbi vendimmarrjen, njoftimet, thirrjet publike, i nënshtrohet ligjit për të drejtën e informimit dhe ligjit për ruajtjen e të dhënave private http://uogj.edu.al/njoftime-te-universitetit-eqrem-cabej/.

Gjithashtu një pjesë e procedurave dhe njoftimet publikohen në buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

UGJ publikon aktet e brendshme të saj, http://uogj.edu.al/legjislacioni/, të dhënat mbi

| |
|---|
| programet e studimit dhe ofertën akademike. Gjithashtu UGJ publikon të dhënat mbi vendimmarrjen e Senatit dhe Bordit të Administrimit, Buxhetin, Marrëveshjet e Bashkëpunimit, në portalin e dedikuar http://uogj.edu.al/marredhenie-dy-paleshe/. <br>UGJ ka vënë në dispozicion një adresë elektronike, për këdo të interesuar për të marrë informacion: info@uogj.edu.al. Studentët, për problematika dhe informacione mbi përditshmërinë e veprimtarisë së tyre në lidhje me sistemin ESSE3, komunikojnë me specialistët e IT-së, në postën e tyre elektronike. |
| **Institucioni bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit.** *(Kreu III Standardi VII.2)* <br>Për të mundësuar koordinimin e informacionit qoftë horizontalisht apo vertikalisht, UGJ ka aplikuar sistemin online për studentët ESSE3, https://www.uogj.esse3.u-gov.rash.al/AddressBook/ABStartProcessoRegAction.do [E2.20]. Qëllimi kryesor është menaxhimi i të dhënave të studentëve dhe përmirësimi i proceseve akademike dhe administrative. Secili përdorues pajiset me një fjalëkalim dhe kod sigurie për të menaxhuar llogarinë e tij. Të dhënat e siguruara nga ESSE3 janë të dhëna të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme vetëm nga personat e autorizuar. <br>UGJ ka përcaktuar qartë personelin përgjegjës, i cili ka akses në të dhënat personale manuale dhe ato elektronike. Struktura përgjegjëse për menaxhimin e database të programit kompjuterik është zyra e IT-së. Specialisti i Zyrës së IT-së përgjigjet për procese të tilla si: grumbullimi, regjistrimi, ruajtja, renditja, përshtatja, rregullimi, shfrytëzimi, përdorimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi i të dhënave personale që bëhen nëpërmjet këtij programi kompjuterik. Personeli që ka akses në këto të dhëna, i përdor ato në përputhje me ligjin për "*Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*", dhe Vendimin e SA[E2.44]. <br>Çdo dokumentacion i bazuar në të dhënat e ESSE3, verifikohet me database në hardcopy (regjistrat e ndryshëm apo dokumenta të tjerë) dhe merr formë ligjore kur nënshkruhet nga personi përgjegjës. Komunikimi midis stafit akademik/ndihmësakademik, studentë dhe anasjelltas realizohet nëpërmjet adresave zyrtare të email-it të stafit dhe studentëve (shkronja e parë e emër mbiemër@uogj.edu.al). Zyra e IT-së ka vënë në dispozicion manualet e përdorimit të tij për stafin akademik dhe për studentët [E2.46]. <br>UGJ ka në dispozicion të personelittë tij dhe të studentëve 1 (një) sallë audiovizive, tre (3) salla kompjuterash dhe 1 (një) sallë multimedia. UGJ ofron disa salla mësimore të pajisura me mjete audiovizive si projektorë, dërrasa inteligjente apo kompjutera në varësi të programit të studimit dhe lëndës përkatëse. Për zhvillimin e orëve laboratorike, UGJ ka vënë në dispozicion të çdo fakulteti/departamenti 18 laboratorë mësimorë [E1.48]. Çdo laborator përmban gjithashtu |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

kompjuterike përkatëse në varësi të kërkesave të departamentit. Aktualisht UGJ nuk ofron programe të edukimit në distancë.

**Institucioni menaxhon pasuritë e paluajtshme.** *(Kreu III Standardi VII.3)*

Në Statutin e UGJ-së [E1.1] shprehet qartë se UGJ ka nën administrim 3 (tre) Godina shtetërore nën pronësinë e MASR-së [E2.47].

UGJ ka kryer vazhdimisht punime të një masterplani mbi sigurinë, rehabilitimin, zgjerimin, dhe ristrukturimin e pasurive të paluajtshme.

Menaxhimi i aseteve në UGJ përcaktohet në Statutin e tij [E1.1]. UGJ për të plotësuar nevojat e të tretëve ka miratuar me Vendim të BA çmimin për dhënien me qera të ambienteve të saj [E2.49].

UGJ mbikëqyr projektet e ndërtimit dhe të rindërtimit të aseteve të saj, nëpërmjet kontraktimit të ekspertëve të jashtëm. Mbikëqyrja dhe kolaudimi i rikonstruksioneve të projekteve të ndërtimit dhe rindërtimit është bërë konform VKM-së, Nr. 354 dt. 11.05.2016.

**Institucioni siguron ruajtjen, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore.** *(Kreu III Standardi VII.4)*

UGJ ndjek një politikë të ruajtjes së trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore, duke shërbyer si një strukturë e depozitimit të infomacionit të shkruar dhe elektronik si dhe të organizimit të aktiviteteve ku promovohen libra, autorë dhe tendenca bashkëkohore kulturore, shkencore e letrare.

UGJ boton periodikisht dhe vë në dispozicion të stafit të tij dhe studentëve Buletinin e saj Shkencor i cili përmban artikujt shkencorë të pedagogëve të UGJ-së, të autorëve të tjerë shqiptarë apo të huaj. Në 1 Shkurt 1989, u botua numri i parë i Buletinit Pedagogjik, i cili më pas (2001) u emërtua Buletini Shkencor "*Kërkime Universitare*", Periodik "*Shkenca Shoqërore dhe të Edukimit*". Ky buletin shërben si një pasuri jo vetëm për UGJ-në por edhe më gjerë dhe po vijohet me përditësimin e artikujve të buletinëve me ISSN, ndërkohë që me Vendim të Senatit Akademik është bërë riformatimi i buletinit dhe i periodikëve të tij në një buletin të vetëm ku përfshihen të tre seksionet me emërtimin "Kërkime Shkencore".Për dixhitalizimin e standardizuar dhe të unifikuar të librit/ tekstit mësimor apo artikujve shkencorë të nevojshëm, UGJ është në proces unifikimi me rrjetin e Bibliotekave Universitare me lider Bibliotekën e Akademisë së Shkencave, për përmbushjen e planit kombëtar për dixhitalizimin e Bibliotekave Universitare dhe atyre të rrjetit.

**Institucioni ndjek një politikë të menaxhimit të aseteve të tij.** *(Kreu III Standardi VII.5)*

UGJ ka një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të tij, me salla leksionesh,

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

| |
|---|
| seminaresh, biblioteka, laboratorë, zyra informacioni për studentët, sekretari, zyra për pedagogët, mjedise relaksi, mjedise shërbimi për të tretë etj, në secilin fakultetet.<br>UGJ disponon mjedise në dispozicion të veprimtarisë së personelit akademik, në përpjesëtim me numrin e tij, duke i krijuar kushte që secili prej stafit akademik, të ketë postin e tij të punës në zyra dhe mjedise të përshtatshme për të zhvilluar aktivitetin mësimor (salla për leksione, seminare, laboratorë etj). Çdo anëtar i personelit akademik dhe ndihmësakademik është i pajisur me bazë logjistike (tavolinë, karrige, dollap, pc apo laptop, printer e fotokopje, kondicionier, mjete kancelarike etj) si dhe gëzon akses në internet në funksion të realizimit të detyrave profesionale respektive. Sipërfaqet e mjediseve që Universiteti ka vënë në dispozicion të stafit akademik, për kryerjen e aktivitetit të tyre didaktik dhe shkencor janë në raport të drejtë me numrin e tyre dhe në përputhje të plotë me standartet shtetërore. |
| **Institucioni ngre një strukturë logjistike administrative për kryerjen e funksioneve me interes të përbashkët** *(Kreu III Standardi VII.6)*<br>Struktura logjistike administrative e UGJ-së është organizuar në mënyrë të tillë që t'i shërbejë interesit të përbashkët. UGJ ofron mjedise për zhvillimin e procesit mësimor, auditore dhe laboratorë si dhe mjedise të pushimit të studentëve, të gjelbëruara dhe me vend qëndrimi. Pranë çdo njësie kryesore ndodhet një bibliotekë e fakultetit. UGJ ka bibliotekën e tij qëndrore, me mjedise të dedikuara për studim nga studentët dhe personeli akademik. Pranë bibliotekës së UGJ-së ka logjistikë të posaçme për organizmin e konferencave, takimeve si dhe një qendër, dedikuar të mësuarit gjatë gjithë jetës. UGJ ka ofruar mjediset e tij në shërbim të të tretëve, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, për veprimtaritë social-kulturore. [2.49]. |
| **Menaxhimi i Veprimtarisë së Institucionit** |
| **Institucioni siguron mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore.** *(Kreu III Standardi V.1)*<br>UGJ ka në dispozicion të studentëve, pedagogëve, studiuesve dhe stafit të tij 3 (tre) godinave (godina A, B dhe C) të cilat janë ristrukturuar herë pas here për të përmirësuar dhe plotësuar standartet e mësimdhënies [E2.48]. Në mënyrë periodike UGJ i nënshtrohet inspektimit të ujit të pijshëm nga DSHSH Gjirokastër si dhe inspektimit Shtetëror Shëndetësor nga Dega Rajonale e Qarkut Gjirokastër [E2.23]. Këto godina janë të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore të cilat plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ. Gjatë rikonstruksioneve të kryera, është siguruar që godinat të plotësojnë standartet teknike të projektit duke ofruar akustikë të mirë dhe të jenë të izoluara nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës. Godinat shtrihen në qendër të zonës urbane |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

larg zonave të zhvillimit industrial apo me ndotje, të cilat gjenden në periferi të qytetit [E2.22]. UGJ siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike dhe administrative: auditor mësimi (53 salla); ambiente për laboratorë në fakultete (25 laboratorë); ambiente për personelin pedagogjik në departamentet përkatëse (76 zyra); ambiente për personelin administrativ pranë zyrave të rektoratit (16 zyra); ambiente teknike dhe magazinimi (në çdo godinë); 1 (një) sallë Senati; 1 (një) sallë audiovizive; tre (3) salla kompjuterësh dhe multimediash. Gjithashtu, UGJ siguron 3 (tre) salla leximi të bibliotekës, të cilat janë të pajisura me mjete audio vizive si projektorë dhe kompjutera [E2.21].

Bazuar në Raportin e MASR-së mbi "*Verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara për vitin akademik 2019-2020*", UGJ ofron një normativë të pritshme sipas fakulteteve si më poshtë:

- Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore ofron një normativë të pritshme prej 3.9 $m^2$/student.
- Fakulteti Ekonomik ofron një normativë të pritshme prej 3.4 $m^2$/student.
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës ofron një normativë të pritshme prej 4 $m^2$/student[E2.21].

UGJ ka vënë në dispozicion të formimit praktik të studentëve mjedise të posaçme, të cilat janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit praktik mësimor. Në total UGJ zotëron 18 laboratorë mësimorë të cilët janë të pajisur me pajisje elektronike dhe të IT-së, sinjal internet free, të cilat garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodave teknologjike bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjithashtu, laboratorët mësimorë sigurojnë infrastrukturën e duhur për zhvillimin dhe realizimin e orëve laboratorike. Bashkëpunimi me institucionet vendëse, publike dhe private, ka qenë në kuadër të realizimit të praktikave mësimore të ofruara në programin e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve (Master profesional).

UGJ i plotëson normativat teknike të ndriçimit natyral, sipërfaqja e dritareve mbulon minimalisht (15 – 20) % të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi është i orientuar nga krahu i majtë i studentit, dhe lartësia e ambienteve është jo më e vogël se 3.0 m (tavan-dysheme) [E2.21]. Aktualisht vetëm Salla "Auditori i Madh" është e vetmja hapësirë që ka kapacitete për më shumë se 200 studentë dhe kanë dalje emergjente. UGJ ka një sistem të mbrojtjes së shkarkesave atmosferike si dhe një sistem të mbrojtjes kundra zjarrit. Çdo godinë është e pajisur me sinjalizues dhe në hollet e çdo godine janë të instaluara bombola kundra zjarrit si dhe hidratantë, të cilët janë të shoqëruar edhe me sinjalistikën përkatëse [E2.22].

Institucioni siguron në pjesën më të madhe të sallave dhe zyrave sisteme ajri të kondicionuar,

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| |
|---|
| ndërkohë që Godinat A,B dhe C kanë të instaluar sistemin e ngrohjes së centralizuar (kaldaja). UGJ disponon burime alternative për furnizimin me energji elektrike (1 motogjenerator në Godinën A) dhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm, pasi uji është i pandërprerë 24 orë. |
| **Institucioni disponon dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike.** *(Kreu III Standardi V.2)*<br>Referuar organigramës [E2.2] së UGJ-së, dhe në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë, Universiteti ka ngritur në strukturën e tij Drejtorinë e Shërbimeve Ndihmës Akademike Administrative (DSHNAA), si një strukturë përgjegjëse për mbledhjen, krijimin, regjistrimin, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentave në nivel institucional. Brenda DSHNAA funksonojnë një sërë zyrash.<br>Zyra Burimeve Njerëzore është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ.<br>Zyra e sekretarisë mësimore është përgjegjëse për mbledhjen, regjistrimin, ruajtjen, përditësimin dhe arkivimin e dokumentacionit institucional dhe të të dhënave personale dhe akademike të studentëve. Sekretaria mësimore e çdo Fakulteti përpilon, administron dhe është përgjegjëse për mirëmbajtjen e regjistrit themeltar të studentëve [E5.1]. Ky regjister plotësohet në formë të shkruar dhe elektronike, pa korrigjime dhe nuk ndryshohet për asnjë arsye. Ai mbahet në ruajtje të përhershme [E2.39]. Çdo student që regjistrohet për herë të parë në UGJ, pajiset me një numër unik matrikullimi nga QSHA , që e shoqëron deri në marrjen e diplomës ose çertifikatës, duke respektuar udhëzimet e MASR-së. Regjistrimi, përdorimi dhe përpunimi i të dhënave personale të studenteve bëhet prej sekretarisë mësimore në përputhje me ligjin Nr.9887, datë 10.3.2008 për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri dhe rregullores se UGJ-se per mbrojtjen perpunimin, dhe ruajtjen dhe sigurine e te dhenave personale **(E.2.44).**<br>Sekretaria mësimore ndjek dhe regjistron hap pas hapi gjithë aktivitetin studimor të studentit sipas planit specifik të studimit, deri në përmbushjen e plotë të detyrimeve akademike Ato mbajnë regjistrin e arritjeve akademike me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, si dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave ku regjistrohen të dhëna mbi diplomën/certifikatën ose diplomat/certifikatat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj., të formatuara këto sipas standardeve shtetërore [E2.44] (E2.45). Regjistrat plotësohet me shkrim, pa korrigjime dhe nuk ndryshohet për asnjë arsye.<br>Sektori i Standarteve dhe Kurrikulave [E 2.2] siguron standartizimin e tërësisë së dokumentit akademik të UGJ (programet mësimore në tërësinë e elementëve të tyre); menaxhon, përpunon dhe sistemon gjithë dokumentacionin e sigurimit të cilësisë; përgatit informacione, raporte e |



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

statistika në përputhje me funksionin dhe në shërbim të UGJ. Zyra e Standarteve dhe Kurrikulave ndër funksionet e saj ka edhe monitorimin dhe depozitimin e syllabuseve për çdo program studimi.

Zyra e IT-së, është përgjegjëse për dixhitalizimin e të dhënave, ruajtjen e dokumentacionit në formë elektronike dhe për mbledhjen e statistikave; planifikon, dizenjon, integron, bart, freskon, menaxhon dhe mbështet sistemet dhe kërkesat e teknologjisë së informacionit, duke përfshirë dhe edukimin elektronik.. Sistemi kompjuterik ESSE3 administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademikdhestudentëve të angazhuar në realizimin e programit [E2.46].

Detyrat rregullohen nëpërmjet rregulloreve: “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike Administrative”; “Për Sekretarinë Mësimore”; “Për krijimin, regjistrimin, ruajtjen, shërbimin, dorëzimin e dokumentave në UGJ e miratuar nga Rektori [E2.43]. Ruajtja dhe administrimi i dokumentacionit akademik dhe administrativë në fakultete dhe departamente është përcaktuar me Vendim të SA [E2.39].

UGJ disponon të dhëna të përgjithshme për programin, formën, planin mësimor, të shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve. I gjithë dokumentacioni ruhet pranë sekretarive [E2.44]. UGJ i ka dedikuar studentëve një hapësirë në faqen e saj të Web-it, e cila u mundëson atyre marrjen e informacionit në lidhje me oraret e provimeve, kalendarin akademik, bibliotekën etj.Po ashtu studentët mund të marrin informacion mbi kurrikulat, regjistrimet në leksione dhe seminare, leksionet e postuara, sallat e mësimdhënies etj,nëpërmjet aksesit të tyre në sistemin ESSE3.

**Përfundimet dhe Vlerësimi**

UGJ ka një përmirësim të dukshëm në fushën e burimeve njerëzore, qoftë në ngritjen e strukturave dhe legjislacionit përkatës, qoftë në procedurat e ndjekura për këtë qëllim. NJSBC është aktive në përmbushjen e misionit të saj. UGJ ka bërë përpjekje të vazhdueshme për kualifikimin e stafit mësimdhënës, me organizimin e disa aktiviteteve për këtë qëllim. Mbetet ende punë për t’u bërë vecanërisht në këtë drejtim, apo edhe në angazhimin e pedagogëve të huaj në mësimdhënie dhe në juritë e promovimit, për të rrit performancën dhe përmirësuar imazhin dhe besueshmërinë e institucionit në rrafsh ndërkombëtar.

Menaxhimi financiar bëhet në përputhje me kuadrin dhe procedurat ligjore të përcaktuara.

UGJ ndjek politika financiare transparente të cilat publikohen rregullishtnë faqen zyrtare të institucionit. Për të mbështetur dhe lehtësuar funksionimin e procedurave akademike, administrative dhe dixhitalizimin e të dhënave, UGJ ka ngritur Sistemin e Menaxhimit të Platformës Mësimore Microsoft TEAMS. Struktura përgjegjëse për menaxhimin e tij është



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

zyra e IT-së. Ajo menaxhon dhe publikon çdo informacion apo dokumentacion në kuadër të informimit, funksionimit, mbarëvajtjes dhe transparencës së gjithë aktivitetit të institucionit në faqen zyrtare të saj www.uogj.edu.al.

UGJ punëson dhe rekruton burimet njerëzore sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme të tij. Institucioni angazhohet në zbatimin e politikave integruese të personelit të vet, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet personelit akademik dhe joakademik për realizimin sa më korrekt të procesit mësimor. UGJ vlerëson arritjet e personelit të tij, duke i evidentuar këto arritje në analizat vjetore mësimore dhe kërkimore-shkencore me nivel departamenti, fakulteti dhe universiteti. Institucioni inkurajon trajnimin dhe promovimin e personelit akademik në universitetet perëndimore, duke shfrytëzuar të gjitha hapësirat e mundshme. Në UGJ favorizohet dialogu social nëpërmjet ngritjes dhe diskutimit të problematikave në strukturat përkatëse. Institucioni zbaton rregulla të qarta për caktimin e përgjegjësive sipas funksioneve përkatëse të përcaktuara në rregulloren e UGJ-së.

Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në UGJ, si institucion publik i Arsimit të Lartë, bëhet në përputhje me rregullat dhe standardet e programimit buxhetor dhe menaxhimin financiar publik. Institucioni ndjek një politikë të ruajtjes së trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore. UGJ ofron një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të tij, me salla leksionesh, seminaresh, biblioteka, laboratorë, zyra informacioni për studentët, sekretari, zyra për pedagogët, mjedise sportive, mjedise shërbimi për të tretë etj. në secilin nga fakultetet e tij. Ende punohet për plotësimin e kapaciteteve infrastrukturore.

UGJ vë në dispozicion për mësimdhënie objekte me materiale cilësore bashkëkohore dhe që plotësojnë kushtet higjeno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ.

UGJ ka një strukturë që përgjigjet për ruajtjen e dokumentacionit në letër. UGJ disponon regjistra bazë të studentëve në formë të shkruar dhe elektronike, ku pasqyrohen të dhënat personale të tyre, arritjet akademike dhe diplomimet/certifikimet së bashku me suplimetet, të cilat ruhen në sekretaritë mësimore .

Infrastruktura logjistike dhe fizike është në përmirësim të vazhdueshëm për t'u vënë në funksion të mbarëvajtjes së gjithë aktiviteteve të institucionit. Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë investime të konsiderueshme për rikonstruksionin e godinave ekzistuese,përmirësimin e logjistikës në auditorë dhe zyra, apo ngritjen e laboratorëve. Bazuar mbi analizat dhe evidencat e raportuara në këtë raport, GVB konkludon se *standartet për fushën Burimet përmbushen* **Kryesisht.**



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

## 3. FUSHA E VLERËSIMIT: KURRIKULA

| Programet e Studimeve të ofruara |
|---|
| **Institucioni ofron programe në përputhje me misionin dhe kushtet e infrastrukturës së tij.** *(Kreu I Standard I.1)* UGJ, si IAL publike ofron programe studimi, në të tre ciklet e studimit, Bachelor (18), Master (8) Master profesional (7), Master i shkencave (5), Doktoratë (1) programe profesionale 2-vjeçare (6) [E1.42]. UGJ siguron mundësinë që programet e studimit të ofruara prej tij të njihen nga publiku. Çdo Fakultet dhe Departament në faqen zyrtare të internetit (http://uogj.edu.al/) hedh të dhënat lidhur me programet e studimit që ofron për çdo cikël studimi (programin, planin mesimor, syllabuset, etj). (http://www.uogj.edu.al/upload/Plan%20programet%202020/Infermjeri%20Mami.pdf). Në stendat e njoftimeve çdo departament afishon planin e studimeve, me të cilin njihen jo vetëm studentët, por edhe publiku i gjerë sa herë është prezent fizikisht në ambientet e UGJ-së. Në strategjinë e çdo njësie akademike dhe administrative të UGJ-së (Rektorat, Fakultet, Departament, Administratë) eshtë mbajtja e kontakteve me shkollat e mesme për informimin e nxënësve me ofertën akademike të UGJ-së, me synim thithjen e studentëve cilësorë. Kjo realizohet nëpërmjet ditëve të hapura informative, kontakteve formale apo joformale të autoriteve drejtuese të UGJ-së me drejtorët e shkollave të mesme, Drejtoritë Arsimore Rajonale, etj. Këto aktivitete koordinohen me Zyrën e Këshillimit të Karrierës, Alumnit [E5.27]. Lista e programeve të studimit të UGJ, është e publikuarnë faqen zyrtare www.uogj.edu.al, si dhe u shpërndahen në formën e fletëpalosjeve, kryesisht maturantëve, gjatë ditëve të hapura [E2.11].Programet e studimit janë në përputhje me misionin e UGJ-së, për të formuar specialistë të lartë dhe përgatitur shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të ndryshme. Programet e studimit të UGJ-së janë programe që lidhen me traditën dhe kulturën e institucionit, por të pasuruara me elemente bashkëkohore, të cilat u përgjigjen nevojave dhe dinamikave të tregut të punës. Programet e studimit ofrohen me kohë të plotë, organizohen në lëndë dhe vlerësohen në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS). Programet e studimeve të ofruara nga institucioni janë të organizuara në mënyrë të tillë që të harmonizojnë të gjithë komponentët e tyre. Ato sipas rastit i nënshtrohen rishikimit, në përputhje edhe me kërkesat e tregut të punës, duke i bërë kurrikulat sa më funksionale dhe të harmonizuara në këta përbërës. |



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

UGJ, me vendimin e Senatit Nr 03 datë 8.09.2020, ka miratuar Rregulloren e Studimeve në Universitetin e Gjirokastrës "Eqrem Çabej" (Rregullorja e studimeve) [E4.8], e cila ka si objekt përcaktimin e rregullave, procedurave, detyrave, përgjegjësive lidhur me realizimin e studimeve në UGJ si dhe i shtrin efektete saj mbi personelin akademik, ndihmësakademik, administrativ si dhe studentët e UGJ-së. Të gjitha njësitë e UGJ-së, kanë harmonizuar rregulloret e tyre si edhe veprimtarinë në përputhje me këtë rregullore [E 4.8].

**Formimi i vazhdueshëm është pjesë integrale e programeve të studimeve.** *(Kreu I Standardi I.2)*

Në UGJ është ngritur dhe funksionon LL (Lifelong learning), në kuadër të të mësuarit gjatë gjithë jetës. Qendra është krijuar në kuadër të projektit për ngritjen e kapaciteteve TEAVET PROJECT WEB SITE (*Developing Teacher Competencies for a Comprehensive VET System in Albania*),zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem trajnimi dhe edukimi gjithëpërfshirës në Shqipëri (https://teavet.org/), si një qendër për trajnimin e mësuesve të arsimit parauniversitar. Qendra ofron infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme për realizimin e moduleve të trajnimit të certifikuar për mësuesit (http://uogj.edu.al/index.php/al/lll-modulet-e-trajnimit). UGJ, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, në bashkëpunim me MASR dhe Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), ka akredituar dhe ofron 16 module trajnimi të certifikuar për mësuesit[E 3.21]. Pjesëmarrja në këto aktivitete është gjithnjë emë e lartë, duke shërbyer edhe si një tregues i domosdoshmërisë për formimin e vazhdueshëm të specialistëve.

**Programet e studimeve ofrohen në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit.** *(Kreu I Standardi I.3)*

UGJ ka miratuar strategjinë e vetë të zhvillimit për periudhën 2020-2025 [E1.33]. Në këtë dokument përcaktohet qartësisht se përmbushja e rolit dhe misionit të UGJ-së bazohet në disa shtylla kryesore (mësimdhënia dhe studimi, profili institucional,edukimi i vlerave, kërkimi shkencor, infrastruktura, bashkëpunimi/partneriteti, ndërkombëtarizimi, sigurimi i cilësisë dhe standarteve, përfshirja dhe përgjegjësi sociale). Oferta akademike e UGJ-së shkon në kah të politikës dhe strategjisë Institucionale të zhvillimit të Universitetit. Programet e studimit në UGJ, të cilat përbëjnë bazën e misionit të mësimdhënies, i përkasin fushave të ndryshme të cilat sigurojnë dhe përgatisin studentët me njohje dhe kompetenca akademike për një karrierë të qëndrueshme profesionale. Objektivat e këtyre programeve janë në të njëjtën linjë me strategjinë e UGJ-së, në tërësinë e procesit të mësimdhënies [E 1.33]. Mbi bazën e këtyre parimeve është mbështetur oferta didaktike e UGJ-së. [E 3.26].

Oferta akademike e UGJ-së integron në mënyrë koherente të gjithë informacionin për diplomat



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

| |
|---|
| e ofruara (përfshirë kurrikulën, planin mësimor, programin, syllabuset) [E3.26]. |
| **Programet e studimeve ofrohen në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë.** *(Kreu I Standardi I.4)*<br>UGJ funksionon vetëm si institucion qëndror dhe nuk ka patur dhe nuk ka filiale të tij në vend. Në UGJ programet e studimit ofrohen në përputhje me objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare, siç përshkruhet edhe në strategjinë dhe në statutin e tij. Të gjitha programet e studimit synojnë të ruajnë dhe konsolidojnë traditën kombëtare shqiptare. Ato ofrohen në përputhje me kornizën kombëtare dhe europiane të kualifikimeve.<br>Oferta akademike e UGJ-së është e larmishme, ku programet e studimit synojnë të jenë programe aktivitetesh gjithëpërfshirëse, ku multidisiplinariteti është tipar i programeve për zhvillimin e aftësive të studentëve dhe konsiderohet si pikë e fortë e ofertës didaktike të UGJ-së (sidomos programet e ciklit të parë), çka lehtëson transferimin dhe fluiditetin në ndjekjen e programeve të ciklit të dytë dhe të tretë. Gjuha e huaj është një disiplinë e pranishme në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë "Master i shkencave" është njohja nga kandidati e një prej gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht [E3.27].<br>UGJ synon të bëhet strehë e vlerave dhe pikë takimeve kulturore mbështetur në Strategjinë e Ndërkombëtarizimit duke forcuar jo vetëm bashkëpunimin ndërkombëtar, por edhe duke u bërë nxitës i tolerancës ndaj respektit dhe njohjes së kulturave të ndryshme [E1.21]. UGJ nuk ka programe studimi të përbashkëta aktive me IAL të tjera, por ka përpjekje dhe inciativa në kuadrin e projekteve ndërkombëtare, për ofrimin e programeve të përbashkëta [E3.28]. UGJ do të vazhdojë përpjekjet për ofrimin e programeve të përbashkëta të studimeve, me partnerë ndërkombëtarë në kuadrin e financimeve dhe bashkëpunimeve Erasmus (Joint Master degree, Joint Phd). Ka universitete dhe institute kërkimore evropiane si italiane, spanjolle, greke etj. që kanë shprehur interesin dhe në disa raste kanë filluar procedurat për programe të përbashkëta dhe bashkëpunime kërkimore shkencore, vecanërisht në fushën e trashëgimisë kulturore, ekonomike dhe të edukimit. |
| **Programet e studimeve ofrohen në përputhje me kapacitetet e institucionit.** *(Kreu I Standardi I.5)*<br>Në të gjitha njësitë bazë të UGJ-së ngarkesa e pedagogëve caktohet në përputhje me aktet nënligjore sipas kategorive të personelit akademik "Asistent-lektorë", "Lektorë", "Profesorë"[E3.30].<br>Ngarkesa mësimore shtesë financohet nga burimet e brendshme të institucionit, duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi [E3.30.1,E3.31]. Programet e studimit dhe planifikimi i |



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| |
|---|
| kohës vjetore të punës të personelit akademik organizohen në mënyrë që të harmonizojnë mësimdhënien e normuar, kërkimin shkencor dhe mbështetjen institucionale, e cila formalizohet nëpërmjet marrëveshjes që lidhet me personelin akademik [E3.32]. |
| **Programet e studimeve janë lehtësisht të kuptueshme dhe objektivat e tyre janë të përcaktuar qartë.** *(Kreu I Standardi I.6)*<br>Në UGJ studentët kanë mundësinë që lehtësisht të jenë në dijeni të përmbajtjes së programit të studimit, kurrikulës dhe programit të lëndës, pasi përmbajtja e programit mësimor, plani mësimor dhe syllabuset janë të publikuara në faqen web të çdo departamenti përgjegjës për zbatimin e programit të studimit(www.uogj.edu.al). Në UGJ është traditë që lektori i çdo lënde orën e parë të fillimit të lëndës informon studentët lidhur me syllabusin e lëndës (njohuritë dhe aftësitë, përmbajtjen, mënyrën e vlerësimit, etj). Informacioni i përmbajtjes së programit të studimit mund të sigurohet lehtësisht nga studentët edhe nëpërmjet sekretarisë mësimore dhe zyrës së këshillimit të karierës. Programet e studimit kanë objektiva të cilat përcaktohen në Rregulloret e Programeve të studimit, si dhe në formularët e aplikimit për hapjen e programeve të reja të studimit. [E3.33 ,E3.34 E 3.35]. Këto objektiva përshkruajnë bashkësinë e dijeve, aftësimeve e kompetencave profesionale që studentët duhet të fitojnë në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin kulturor e profesional të tij. Për të gjitha programet e studimit që ofrohen nga UGJ përcaktohen kriteret e pranimit. Statuti i UGJ-së, përcakton parimet e përgjithshme të pranimit të studentëve në të tre ciklet e studimeve[E1.1].<br>Në programet e studimit të ciklit të parë kriteri kryesor është ai i notës mesatare të shkollës së mesme.Kriteret e pranimit në ciklin e parë për çdo program studimi pasqyrohen edhe në portalin *u-albania*. Në programet e studimit të ciklit të dytë kriteret bazë që aplikohen janë nota mesatare dhe fusha e studimit [E3.3,E3.4]. |
| **Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen e studentëve me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme.** *(Kreu I Standardi I.7)*<br>Statuti i UGJ-së thekson se studimet në UGJ organizohen në tre cikle të njëpasnjëshme referuar niveleve 6, 7 dhe 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në Statut paraqitet qartazi kalimi progresiv nga cikli i parë në ciklin e dytë të studimeve.<br>Të gjitha programet e ciklit të parëtë studimevejanë të organizuara me 180 kredite dhe japin akses në ofertën akademike të ciklit të dytë të ofruar nga UGJ dhe IAL të tjera brenda dhe jashtë vendit [E3.26]. Larmia e madhe e disiplinave të ofruara në programet e studimit të ciklit të parë mundëson gjithashtu një larmitë oportuniteteve të studentëve për ndjekjen e studimeve të ciklit të dytë.<br>Ndarja e disiplinave në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë ndjek rigorozisht ndarjen |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| |
|---|
| në disiplina si lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse, duke pajisur studentët me njohuritë bazë, mbi metoda dhe parime shkencore të përgjithshme dhe formimin e shprehive të veçanta. |
| **Programet e studimeve të ciklit të parë hartohen në mënyrë të tillë që të lehtësohet ambientimi i studentit me mjedisin universitar.** *(Kreu I Standardi I.8)*<br>Në UGJ studentët me rezultate shumë të mira, studentët që studiojnë në fusha prioritare dhe studentët në nevojë përfitojnë bursë sipas legjislacionit në fuqi (**VKM 39, 23.01.2019, VKM 40, 23.01.2019; VKM 780, 26.12.2018)** [E2.25]. Për të mbështetur studentët me ecuri të mirë, UGJ u mundëson studentëve mobilite studimore në Universitetet me të cilët UGJ ka marrëveshje bashkëpunimi (Erasmus, etj) Kriteri i meritës (nota mesatare) aplikohet për përzgjedhjen e studentëve për këto mobilitete [E1.64]. Një tjetër aspekt i mbështetjes së ecurisë së studentëve është organizimi i konferencave studentore dhe ngritja e laboratorëve në mbështetje të procesit mësimor [E3.38].<br>Rregullorja e UGJ-së dhe Rregulloret e Programeve të Studimit përmbajnë rregulla të qarta në lidhje me regjistrimet, kalimin në vitet pasardhëse, të drejtat dhe detyrimet e studentit, etj. Sistemi ESSE3 i UGJ-së, në të cilin studentët kanë akses të plotë, është i konceptuar që të minimizojë gabimet e mundshme të studentëve dhe të lehtësojë procedurat. Zyra e Këshillimit të Karrierës orienton studentët për probleme të ndryshme të ecurisë së tyre akademike. Stafi Akademik në Departamente ka orë konsultimi me studentët.<br>Stafi akademik i UGJ-së përveç formës tradicionale të mësimdhënies, e cila është mbizotëruese, aplikon edhe forma alternative/interaktive. Kjo realizohet duke shfrytëzuar kapacitetet teknologjike nëpërmjet prezantimeve audiovizive, komunikimeve online, internetit, rrjeteve sociale etj. |
| **Programet e studimeve të ciklit të dytë mbështeten mbi kërkimin dhe për realizimin e tyre institucioni bashkëpunon me aktorë të fushës ekonomike.***(Kreu I Standardi I.9)*<br>Në përputhje me misionin e arsimit të lartë, në UGJ, programet e studimit të ciklit të dytë, mbështeten mbi kërkimin. Studentët e ciklit të dytë kanë një orientim të mirëfilltë kërkimor shkencor, ndërsa studentët e masterit profesional, kanë një orientim drejt kërkimit praktik. Programet e studimeve hartohen nga departamentet dhe janë rezultat i propozimeve dhe diskutimeve të të gjithë anëtarëve të departamentit. **(E1.42 ).**<br>Praktika profesionale zhvillohen si pjesë e planevë mësimore, në bashkëpunim me sektorin privat dhe kompanitë shtetërore, duke e përmbyllur praktikën me vlerësim. **(E3.45).**<br>Studentët përgatisin temat e tyre të diplomës, nën tutorimin e pedagogëve udhëheqës si dhe udhëzimeve përkatëse, në formën e një manuali për punimin e diplomës. **(E4.8 ).** Ky dokument |



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

realizon mbështetjen dhe organizimin e efektshëm të procedurave të përgatitjes, udhëheqjes, mbrojtjes dhe vlerësimit të punimit të diplomës.

Institucioni në mësimdhënie në programet e studimeve master, ka angazhuar personel akademik të ftuar, të cilët janë studiues dhe personalitete vendas apo të huaj. **(E3.39 ).**

**Programet e studimeve synojnë të nxisin mobilitetin e studentëve Shqiptarë në Europë dhe më gjerë.** *(Kreu I Standardi I.10)*

Në UGJ të gjitha programet e studimit ofrohen në përputhje me procesin e Bolonjës, në tre cikle studimi, Bachelor, Master, Doktoratë, referuar niveleve 6,7,8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve [E 1.1] Programet e studimit të UGJ, nëpërmjet formatit të programit lëndor japin informacion të mjaftueshëm edhe për një vëzhgues të huaj: prezantimi i përmbajtjes së formatit është i detajuar (në të gjitha të dhënat sasiore të tij: orët mësimore, orët e studimit individual, kreditet, format e vlerësimit etj.). Programi i studimit është i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar në kredite europiane sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), por nuk është i disponueshëm për të gjithë edhe në gjuhën angleze. Diplomat që jepen në përfundim të programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës, e cila është e disponueshme në gjuhën shqipe dhe angleze për të gjitha programet e studimit [E3.41].

Programet e studimit në UGJ, ofrojnë mundësinë e përvetësimit të një kurrikule të përditësuar, e dëshmuar edhe nga numri i lartë i marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura me universitetet partnere në kuadër të projekteve Erasmus+ për mobilitetet afatshkurtra[E 1.64].Studentët janë jo vetëm përfitues të mobilitetit, por gjithashtu procesi i njohjes së këtyre periudhave të mobilitetit, është një proces, i cili realizohet në masën 100% në çdo program studimi me një nivel të njohjes së krediteve në masën 75%. Studentët mund të jenë përfitues të mobilitetit, vetëm një herë gjatë një cikli studimesh. Periudha e mobilitetit, në varësi të marrëveshjes së bashkëpunimit zgjat nga një semestër deri në një vit akademik. Institucioni ruan një databasetë dhënash për mobilitetet e realizuara. Krahas studentëve të UGJ [E 1.64], të cilët realizojnë mobilitete në universitetetet partnere, në UGJ ka dhe studentë të universiteteve partnere, të cilët realizojnë periudhat e mobilitetit të tyre, pranë programeve të studimeve të UGJ.

UGJ, në rregulloren e studimeve, ka përcaktuar mundësinë e organizimit të sezoneve të posaçme për realizimin e provimeve.

Universiteti ofron mundësi për transferim të krediteve të fituara brenda ose jashtë vendit, nëpërmjet ekuivalentimit të pjesëve ose programeve të plota të studimeve nga pikëpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm në një institucion partner.



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| |
|---|
| **Programet e studimeve mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike.** *(Kreu I Standardi I.11)*<br>Programet e studimit organizohen sipas përbërësve të ndryshëm, ku zbatimi në praktikë i njohurive është një përbërës i rëndësishëm. Orët në auditor organizohen në të gjitha programet në leksione e seminare (ushtrime praktike), në orë laboratori, por shumë pedagogë përdorin metoda interaktive dhe nuk përdorin ndarjen tradicionale: leksion/seminar.<br>Zbatimi i njohurive teorike bëhet edhe përmes projekteve të kursit, detyrave të lëndëve, të parashikuara në syllabuset e miratuara për çdo program studimi.<br>Institucioni mbështet nga ana organizative dhe financiare, realizimin e praktikave mësimore, disa ditore, jashtë universitetit(praktikat në terren). Praktikat në terren janë pjesë e disa programeve të studimit, kryesisht të shkencave humane dhe atyre natyrore [ E3.45]. |
| **Programet e studimeve synojnë përgatitjen e studentëve për punësim.** *(Kreu I Standardi I.12)*<br>Në UGJ, Njësitë bazë dhe kryesore përfshijnë në programet e studimeve disiplina karakterizuese (me karakter të mirëfilltë profesional) në rreth 90 – 99 kredite (ECTS), (50-55%) dhe lende integruese me lende karakterizuese (21 - 27 kredite 12-15 % ), lëndë plotësuese (18 – 27 kredite 10-15%) ku mund të përfshihen module lëndore të kulturave juridike, ekonomike.<br>Shumica e programeve të studimit (cikli I+II), në UGJ përfshijnë praktikat mësimore si pjesë integrale e tyre [E 3.45] |

**Përfundimet dhe Vlerësimi**

Në UGJ programet e studimit organizohen për të përmbushur standartet kombëtare të cilësisë, duke respektuar në formë dhe përmbajtje kërkesat që burojnë nga aktet ligjore dhe nënligjore. Ato janë në përputhje me objektivat e zhvillimit institucional. Përmbajtja e programeve të studimit të ofruara nga UGJ synon të përmbushë skenarin e lidershipit profesional të parashikuar në planin strategjik të zhvillimit institucional. Programet e studimit hartohen që të lehtësohet mobiliteti i studentëve brenda dhe jashtë vendit. Gjatë hartimit të këtyre programeve merren në konsideratë nevojat dhe kërkesat e lidhura me tregun e punës, informacionet e marra nga burime të ndryshme jashtë Universitetit, përvojat e Universiteteve të huaja, burimet në dispozicion si dhe objektivat strategjike të zhvillimit institucional. Programet e studimit kanë objektiva të qarta formimi dhe aftësimi të studentëve. Rregullat e ecurisë së përparimit në programet e studimit parashikohen në formularët e aplikimit për hapjen e programeve të reja, në rregulloret e programeve të studimit dhe në rregulloren e UGJ-së. Në UGJ programet e studimit analizohen për të vlerësuar perfomancën tyre dhe nxjerrjen e përfundimeve përkatëse. Bazuar në këto përfundime, programet e studimit në UGJ i nënshtrohen përmirësimit të vazhduar, duke u bazuar në indikacionet që vijnë nga burime brenda dhe jashtë UGJ-së, si dhe në ndryshimet që pësojnë këto programe në universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit.Personeli akademik i UGJ-së është garancia për sigurimin e cilësisë akademike në këto programe studimi.

Bazuar mbi analizat dhe evidencat e raportuara në këtë raport, Grupi i Vetëvlerësimit konkludon se në UGJ *standartet për fushën e Kurrikulave plotësohen* **PLOTËSISHT.**



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

## 4. FUSHA E VLERËSIMIT: MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KËRKIMI

| Organizimi i Programeve të Studimeve |
|---|
| **Programet e studimeve të shpallura zbatohen në kushte të përshtatshme.** *(Kreu I Standardi II.1)*<br>UGJ siguron organizimin dhe dokumentimin efikas të planit mësimor të programeve të studimeve. Mënyra e organizimit të studimeve të ofruara nga UGJ dhe dokumentimi mësimor në formë të shkruar janë të përcaktuara qartë në statutin dhe rregulloren e UGJ [E1.1, E1.5]. Ndërkohë, rregulloret e njësive bazë të UGJ [E1.6, E1.7, E1.8] sigurojnë zbatimin në kushte të përshtatshme të programeve të studimit që ofrojnë, në përputhje me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Dokumentimi efikas i çdo programi studimi sigurohet nëpërmjet dosjes së programit të studimit që përmban të gjithë informacionin e nevojshëm (informacion për institucionin, programin e studimit, strukturat akademike përgjegjëse dhe të tjera bashkëpunuese, kuadrin e përgjithshëm formues të programit të studimit, personelin akademik për realizimin e programit, planin mësimor, infrastrukturën në dispozicion të programit, kriteret e pranimit, planin mësimor, syllabuset e lëndëve, rregulloren e programit të studimitdhe suplementin e diplomës) [E3.7, E3.8, E3.9, E3.10]. Zbatimi korrekt sigurohet edhe nëpërmjet shpalljes së orarit të përgjithshëm që bëhet çdo fillim semestri ku janë përcaktuar qartë format e mësimdhënies, dita, ora edhe salla ku do zhvillohet si dhe pedagogu përkatës [E4.1]. Orari publikohet në faqen web të UGJ [E4.2] dhe afishohet në mjediset e UGJ.<br>Regjistrimi i studentëve në lëndët mësimore realizohet nëpërmjet sistemit elektronik ESSE3, ku çdo student dhe staf akademik i UGJ disponon llogarinë e tij personale dhe manualin e plotë sesi mund të aksesojnë apo të përdorin sistemin[E2.20].<br>Institucioni bashkërendon punën e personelit akademik për të siguruar koherencë të përmbajtjes duke përputhur kualifikimin e stafit akademik me specifikat e programit. Në dosjen e çdo programi studimi është përcaktuar dhe personeli akademik sipas fushës së specialitetit [E3.7]. UGJ garanton kapacitete të mjaftueshme për realizimin e formimit praktik e profesional të studentëve, i cili realizohet nëpërmjet punëve laboratorike që mundësohen në laboratorët e njësive bazë. UGJ ka në total 25 laboratore [E1.48] ndërkohë që praktikat mësimore mundësohen sipas specifikave në terren apo në institucione në sajë të marrëveshjeve të bashkëpunimit që UGJ ka me institucione të ndryshme [E4.24]. Praktikat mësimore mbikëqyren nga pedagogu përkatës që mund të jetë staf i punësuar më kohë të plotë apo me kohë të pjesshme [E3.45]. Programi i |



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

doktoraturës në UGJ ka rregulloren e saj ku janë të përcaktuara qartë rregullat dhe kriteret e diplomimit [E1.19]. Literatura e nevojshme, bazë dhe mbështetëse për programin e studimeve u vihet në dispozicion studentëve për çdo lëndë mësimore jo vetëm nëpërmjet pasqyrimit të saj në syllabusin e lëndës [E3.20], dhënies së informacionit që në orën e parë të leksionit, por edhe nëpërmjet bibliotekës së UGJ [E4.5]. Çdo fillim viti akademik në çdo departament miratohet literatura bazë, që do të përdoret për programin e studimit [E4.4]. UGJ ka përcaktuar standartet dhe kriteret që duhet të përmbushi literatura që stafi akademik sjell për tu shqyrtuar dhe miratuar në departament [E4.5] dhe që mund të përdoret si literaturë bazë. Literatura e nevojshme mbështetëse u sigurohet dhe nga pasurimi i vazhdueshëm me literaturë, ku sipas kërkesave të fakulteteve mundësohet blerja e tyre nga fondet e UGJ, por edhe nga donacione të ndryshme [E4.6, E4.7]. Tashmë studentët e UGJ kanë akses nëpërmjet platformës digjitale U- L I B R A R Y https://ulibrary.rash.al/, ku mund të gjejnë edhe literaturën mbështetëse ndihmëse për programin mësimor dhe jo vetëm.

**Institucionet e Arsimit të Lartë pajisin studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.** *(Kreu I Standardi II.2)*

Rregullat dhe kërkesat për diplomim janë të përcaktuara qartë në rregulloren e UGJ [E1.5,] në rregulloret e njësive bazë [E1.6, E1.7, E1.8], të programeve të studimit që janë të shpallura publikisht dhe u bëhen të njohura studentëve që në orët e para të mesimit. Rregullat dhe kërkesat e provimit të diplomimit janë të miratuara nga strukturat universitare përgjegjëse dhe janë të njohura për të gjithë përmes rregullores. UGJ bën të njohura (shpall në vende të dukshme) kriteret dhe procedurat e diplomimit, sipas rregulloreve përkatëse. Ato janë të afishuara në stendat e secilit fakultet dhe të publikuara online në faqen zyrtare të internetit të UGJ-së. Studentëve u bëhen me dije datat e provimeve, datat e diplomimit, në ambiente publike në fakultetet përkatëse si dhe në faqen web të institucionit.

Anonimati është i respektuar gjatë korrigjimit të provimeve. Të gjitha provimet me shkrim bëhen me sekretim, procedurë që përcaktohet në rregulloren e studimeve. Pasi bëhet vlerësimi komisioni i jep përgjigjen secilit prej studentëve sipas afateve të përcaktuara në rregullore. Ankimimi i rezultateve të provimeve shqyrtohet nga një komision i ngritur në përputhje me rregulloren e studimeve, rregulloren e fakultetit dhe programit të studimit përkatës, gjithmonë duke respektuar afatet e ankimimit të përcaktuara në rregullore [E4.8]

Studentët kanë akses në rezultatet personale të provimeve, duke respektuar parimin e konfidencialitetit. Secili nga studentët ka *username* dhe *password* personal të sistemit online



REPUBLIKA E SHQIPERISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| |
|---|
| ESSE3, ku mund të verifikojnë rezultatet e provimeve, të cilat i komunikohen edhe verbalisht nga komisioni në afatin e caktuar sipas rregullores [E2.46]. |
| **Programet e studimeve janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm të tyre në funksion të rritjes së cilësisë.** *(Kreu I Standardi II.3)*<br>Personeli akademik vlerësohet nga struktura të institucionit që ndjekin zbatimin cilësor të programeve të studimeve, si dhe nga strukturat drejtuese: dekanati, në mbledhjet e analizës së punës mësimore; departamenti në analizat vlerësuese përgjatë vitit akademik, nga zëvendësrektori i caktuar për vlerësimin e performancës së pedagogut. Element shumë u rëndësishëm për vlerësimin janë edhe pyetësorët institucionale dhe pyetësorët për procesin mësimor, që organizohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë NJSBC [ E1.1 E.1.31].<br>Studentët, si fokusi kryesor i Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit, kontribuojnë në mënyrë direkte me vlerësimin e tyre mbi institucionin dhe cilësinë e mësimdhënies. Ky kontribut është burim i rëndësishëm informacioni për rritjen e cilësisë së shërbimeve institucionale dhe akademike që ofron UGJ [E4.9].<br>UGJ vlerëson arritjet e personelit të tij, duke i evidentuar këto arritje në analizat vjetore mësimore dhe kërkimore-shkencore në nivel departamenti [E2.40].Personeli akademik plotëson skedën vetjake të vlerësimit të veprimtarisë së vet shkencore, e cila dorëzohet dhe pasurohet në fund të çdo viti akademik.<br>Në fund të çdo viti akademik, rishikohen programet e studimit për t'u përditësuar dhe përmirësuar në mënyrë që kurrikula të jetë sa më funksionale dhe të përshtatet më mirë me kërkesat e tregut të punës. Diskutimi zhvillohet në fillim në departamente, më tej propozimet për ndryshim i përcillen dekanatit ku sërish ka diskutim në lidhje me propozimet e bëra dhe më tej i përcillen Senatit Akademik për diskutim dhe vendimmarrje. Merret në konsideratë mendimi i studentëve. |
| **Institucioni ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.** *(Kreu I Standardi II.4)*<br>Departamenti është një strukturë bazë, e cila promovon përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, por politika e universitetit është inkurajimi i mobilitetit të personelit akademik, me qëllim shkëmbimin e eksperiencave në lidhje me përmirësimin e mësimdhënies në universitet.<br>UGJ inkurajon dhe mbështet personelin akademik në fushën e kërkimit shkencor, duke e konsideruar këtë si një prioritet strategjik në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të mësimdhënies. Njëkohësisht ofron lehtësira në mënyrë që stafi të përqendrohet tek kërkimi shkencor, nëpërmjet reduktimit të ngarkesës mësimore, vitit sabatik etj. |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Personeli akademik trajnohet vazhdimisht për përmirësimin e mësimdhënies, nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të projekteve, në të cilat UGJ është partner. Në UGJ implementohen projekte për ngritjen e kapaciteteve, të cilët kanë në fokus ngritjen ekapaciteteve humane, nëpërmnjet trajnimeve dhe kualifikimeve, rritjen e kapaciteteve infrastrukturore, nëpërmjet ngritjes së labratorëve të dedikuar për këtë qëllim si dhe shkëmbimit të vizitave studimore ndërmjet partnerëve. Informacioni mbi projektet ku UGJ bën pjesë, gjendet dhe i publikuar në faqen web, së bashku me link-et përkatëse të secilit projekt (http://uogj.edu.al/projekte-nderkombetare/).

Senati i UGJ-së ka përcaktuar modalitetet dhe standardet e rekrutimit të personelit akademik, ndërkohë që departamentet përcaktojnë kritere sipas specifikave, që ato kanë në lidhje me këto rekrutime [E 2.1]. UGJ nuk ka terrene të mjaftueshme sportive në mjediset e veta, por përmes marrëveshjeve të lidhura me institucione publike apo private, është mundësuar në vijimësi sigurimi i këtyre hapësirave të nevojshme [E 4.24].

**Kërkimi: Rezultatet e kërkimit, përhapja, vlerësimi dhe transferimi i tyre.**

**Departamenti, si njësi bazë e institucionit, evidenton anët e tij të forta dhe dobësitë në fushën e kërkimit shkencor.** *(Kreu II Standardi I.1)*

UGJ ka 3 njësi kryesore me 12 njësi bazë. Secila prej këtyre njësive është e grupuar sipas disiplinave mësimore përkatëse dhe në to veprojnë grupet mësimore-kërkimore përkatëse, të cilat kryejnë hulumtime të ndryshme studimore të fushave të ndërlidhura me programet që ato mbulojnë. Grupet e kërkimit janë të përbërë nga anëtarë të personelit të fokusuar kryesisht në kërkime dhe publikime, për t'i dhënë shtysë kërkimit shkencor në UGJ, në përputhje me strategjinë afatgjatë të zhvillimit të institucionit **[E 1.33]**

Njësia bazë përgjigjet për ecurinë e punës kërkimore shkencore të grupeve kërkimore në përputhje me planin vjetor, gjithashtu ajo monitoron grupet kërkimore rregullisht dhe koordinon aktivitetet kërkuese. Në periudha të ndryshme, anëtarët e Njësisë Bazë ndajnë mes tyre informacionin në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore që ata zhvillojnë dhe shprehin kërkesat që ata mund të kenë në lidhje me lehtësimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore. Çdo departament ka përgjegjësi të hartojë një raport të përvitshëm që vlerëson ecurinë e punës kërkimore shkencore të grupeve kërkimore. Përgjegjësi i Njësisë bazë bën të njohur arritjet e departamentit nëpërmjet nxitjes së botimeve didaktike- shkencore, përfshirjes ose bashkëpunimit në projekte dhe përditësimit të rubrikave në faqen ëeb të Ugj-së; Njësitë bazë UGJ-së mbështeten financiarisht në mënyrë transparente. Plani i buxhetit institucional parashikon fonde për kërkimin shkencor për çdo departament. [ E 1.1 E 1.5]

Njësitë bazë në UGJ bazuar në rezultatet e punës së grupeve kërkimore sugjerojnë vazhdimësinë

| |
|---|
| ose ndërprerjen e veprimtarisë së tyre. |
| **Institucioni inkurajon zhvillimin, dinamizmin dhe kërkimin shkencor.** *(Kreu II Standardi I.2)*<br>Institucioni mbështet grupet dhe projektet kërkimore shkencore të reja. UGJ mirëpret dhe inkurajon propozimet kërkimore dhe vendos mbi ecurinë e tyre gjatë gjithë vitit akademik, duke u bazuar në burimet financiare të miratuara[E2.15, E2.16].<br>UGJ është duke bashkëpunuar me institucionet e tjera kërkimore publike dhe private sidomos në fushën e mësimdhënies[E1.62].<br>Strukturat e ndryshme brenda UGJ-së ndërveprojnë me njëra-tjetrën, por edhe me institucione të ndryshme publike apo private brenda dhe jashtë vendit për të mundësuar ofrimin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. |
| **Institucioni përqendrohet në ndërkombëtarizimin e kërkimit** *(Kreu II Standardi I.3)*<br>UGJ organizon si dhe merr pjesë në konferenca shkencore të organizuara nga institucione të tjera. Kjo pasqyrohet rregullisht edhe në faqen e internetit të institucionit. Secili prej fakulteteve ka organizuar disa konferenca kombëtare apo ndërkombëtare në partneritet me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit. Në pesë vitet e fundit janë organizuar gjithsej 12 konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare me tematika të ndryshme që lidhen me politikën zhvillimore të UGJ-së si dhe me tendencat e zhvillimit të tregut dhe kërkimit shkencor në vazhdimësi[E4.18].Të gjitha aktivitetet publikohen në faqen web të institucionit http://uogj.edu.al/gjithe-aktivitetet/ si dhe në rrjetet sociale zyrtare: https://www.facebook.com/Universiteti-Eqrem-Cabej-Gjirokastër-Faqja-Zyrtare<br>UGJ disponon kapacitetet për të qenë i pranishëm në mjediset akademike ndërkombëtare. Anëtarët e personelit akademik përveç veprimtarisë së mësimdhënies i kushtojnë vëmendje angazhimeve në fushën e kërkimit shkencor përmes pjesëmarrjes në konferenca shkencore ndërkombëtare, botimit të artikujve shkencorë në revista shkencore ndërkombëtare apo edhe angazhimeve të tjera të këtij lloji [E 4.22].<br>UGJ ka nënshkruar marrëveshje të shumta me IAL-të brenda dhe jashtë vendit. Procesi i ndërkombëtarizimit është një nga prioritetet e institucionit. Për këtë arsye, rritja e bashkëpunimit, organizimi i eventeve të përbashkëta dhe iniciativat e ndryshme për kërkimin shkencor, kanë nisur nga këto marrëveshje për t'u konkretizuar në projekte të mirëfillta të cilat implementohen sot. |
| **Institucioni përcakton fushat parësore të kërkimit shkencor.** *(Kreu II Standardi I.4)*<br>Departamentet dhe grupet e kërkimit shkencor, mbështetur në propozimet e anëtarëve të saj, |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| |
|---|
| përcaktojnë fushat bazë të kërkimit si dhe orientojnë prioritetet e institucionit në fushën e kërkimit shkencor, duke patur për bazë edhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. [ E 1.1 E 1.5 ]Këto prioritete janë në përputhje me qëllimet institucionale. Metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies, Zhvillimi historik dhe linguistik; Biodiversiteti dhe mjedisi, Zhvillimet demografike, Turizmi etj, janë fushat e studimit të propozuara nga Njësitë bazë dhe kryesore.<br>UGJ favorizon debatin shkencor në fushat parësore të kërkimit shkencor. Kjo realizohet përmes organizimit të ditëve akademike, leksioneve të hapura, diskutimeve të ligjëratave të reja në departamente, seminareve, ku personeli akademik angazhohet në diskutim të ideve dhe arritjeve shkencore. |
| **Institucioni zbaton prioritetet kërkimore shkencore.** *(Kreu II Standardi I.5)*<br>Institucioni siguron mjetet për zbatimin e prioriteteve të përcaktuara prej tij. UGJ ka ngritur dhe përmirëson në vazhdimësi infrastrukturën në mbështetje dhe funksion të veprimtarisë kërkimore shkencor. Struktura dhe organet e UGJ-së sigurojnë mjetet (si laboratorët, mjediset e bibliotekave etj.) për zbatimin e prioriteteve të caktuara. Mjediset, stafi, mbështetja që sigurohet nga institucioni mundësojnë zbatimin e tyre.<br>Institucioni rekruton personel akademik të kualifikuar në fushën e kërkimit shkencor, në funksion të strategjisë për zhvillim të institucionit. UGJ bën kujdes në afrimin e personelit akademik të kualifikuar në fushën e kërkimit shkencor, e shprehur kjo në rregulloren e rekrutimit të stafit akademik. [ E 2.1] UGJ u jep prioritet aplikantëve që zotërojnë grada apo tituj akademikë, veçanërisht atyre që këto tituj i kanë marrë në universitete të huaja.<br>Prioritetet kërkimore të UGJ-së si: forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar në fushën e kërkimit, rritja e bashkëpunimit mes komunitetit të kërkuesve dhe atij të biznesit etj, janë në përputhje me qëllimet institucionale, të cilat rrjedhin nga politikat zhvillimore të institucionit. |
| **Institucioni siguron vazhdimësi në fushën e kërkimit shkencor.** *(Kreu II Standardi I.6)*<br>Kërkimi shkencor përbën një nga pikat kyçe të strategjisë së zhvillimit të UGJ-së[E1.43].<br>UGJ bashkëpunon në mënyrë të ngushtë me institucione private dhe publike kombëtare në bazë të memorandumeve të bashkëpunimit dhe kontratave. UGJ ka bashkëpunim të ngushtë me struktura të Akademisë së Shkencave, Akademisë së Studimeve Albanologjike, universitete të tjera të RSH-së etj.<br>Institucioni ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj. UGJ ka zgjeruar dhe mirëpret çdo bashkëpunim me studiuesit e huaj. Është mundësuar prania e disa studiuesve të huaj në UGJ duke marrë pjesë në konferencat ndërkombëtare të organizuara pranë UGJ-së, gjithashtu studiues të huaj kanë marrë pjesë si personel akademik i ftuar, në programe të ndryshme studimit |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË · UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

në universitetin tonë[E1.38].

UGJ ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik. UGJ inkurajon personelin akademik për të marrë pjesë në projekte kërkimore në institucione brenda dhe jashtë vendit. Pjesëtarë të personelit akademik të UGJ-së janë lektorë apo pjesëtarë të grupeve kërkimore në universitete jashtë vendit. Dhënia e lejeve administrative të pagueshme për pedagogë që marrin pjesë në projekte afatshkurtra, krijimi i lehtësirave për mobilitetin, akordimi i vitit sabatik, për pedagogë që kryejnë kërkime shkencore afatgjata, janë praktika të mira në këtë drejtim[E1.37,E.1.38].

UGJ, për të nxitur rritjen e cilësisë dhe ndërkombëtarizimin e studimeve, fton personel akademik të huaj të marrë pjesë në mësimdhënie në formën e leksioneve të hapura si dhe me angazhime me kohë të pjesshme.

**Institucioni bën të njohura rezultatet në fushën e kërkimit shkencor.** *(Kreu II Standardi I.7)*

Ugj në zbatim të ligjit Nr.80 / 2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ka detyrimin të bëjë publike veprimtarinë kërkimore-shkencore si edhe rezultatet përkatëse. UGJ ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor. Këtë e bën duke publikuar në organin e vet "Buletini shkencor", i cili është edhe ndërkombëtarisht i verifikueshëm, vëllime me përmbledhje të referimeve, kumtesa të mbajtura në kuadër të një veprimtarie shkencore (simpozium, konferencë, kongres etj), publikimi online i rezultateve të veprimtarisë kërkimore në faqen zyrtare të institucionit, etj.

**Institucioni ndjek një politikë të vlerësimit dhe transferimit të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.** *(Kreu II Standardi I.8)*

Performanca e punës kërkimore e të gjitha llojeve e niveleve vlerësohet nga Njësitë bazë (grupet kërkimore brenda tyre), Njësitë kryesore të UGJ-së si dhe nga Senati Akademik. Njësitë bazë (pëgjegjësit), organizojnë analiza periodike dhe vjetore për realizimin e detyrave të punës shkencore referuar planifikimeve vjetore të secilit anëtar. Në bashkëpunim me strukturat ndihmëse (njësitë bazë e kryesore), Zëvendësrektori për shkencën dhe marrëdhnjet me jashtë përgatit raportin vjetor të veprimtarisë kërkimore të universitetit dhe ja paraqet Rektoratit për miratim dhe më pas Senatit Akademik. Procesi i vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë realizohet çdo katër vjet nga AKKSHI, në përputhje me kriteret. Kriteri bibliometrik, impaktit të kërkimit shkencor, infrastruktural, kapaciteteve njerëzore dhe ndërkombëtarizimit. Vlerësimi për çdo tregues që përbën kriteret e vlerësimit, në nivel njësie bazë, realizohet nëpërmjet një sistemi pikëzimi algoritmik, në mënyrë automatike nga platforma elektronike, Sistemi Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor–ACRIS.



REPUBLIKA E SHQIPERISE · UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Garantimi i aksesit për transferimin e informacionit mbi rezultatet, produktet e të gjithë llojeve të veprimtarisë së kërkimit shkencor në UGJ realizohet nëpërmjet platformës online me akses të hapur dhe përditësimit të saj. Gjithashtu UGJ boton periodikisht dhe vë në dispozicion të stafit, studentëve, komunitetit të kërkuesve dhe atij të biznesit, Buletinin e saj Shkencor "Kërkime Universitare", ku vijohet me përditësimin e artikujve të buletinëve me ISSN. Organizimin e konferencave shkencore, semiareve, promovimet ne rrjetin e medias rajonale etj.

**Përfundimet dhe Vlerësimi**

UGJ ka një sistem efektiv për zbatimin në kushte të përshtatshme të programeve të studimit që ofron. Studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi pajisen me dokumentin zyrtar, që është diploma përkatëse. Programet e studimit në funksion të rritjes së cilësisë janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm duke marrë për bazë vlerësimet e studentëve, nevojat dhe kërkesat e tregut të punës si dhe integrimin efektiv të teorisë me praktikën. Në përmbushje të rekomandimeve të Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (Maj 2017), për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, UGJ ka tashmë një skemë efektive nëpërmjet miratimit të Strategjisë së Kërkimit Shkencor e cila siguron mundësitë që veprimtaria kërkimore shkencore të kryhet në përputhje me misionin, fushat e kompetencës, si dhe me standartet e pranuara kombëtare dhe ndërkombëtare. UGJ ka një strategji të kërkimit shkencor dhe stafit akademik i siguron mundësitë që veprimtaria kërkimore - shkencore të kryhet në përputhje me standartet e pranuara kombëtare dhe ndërkombëtare. UGJ inkurajon frymën e bashkëpunimit në kërkimin shkencor midis stafit, studentëve dhe institucioneve të tjera kërkimore brenda dhe jashtë vendit.

Bazuar mbi analizat dhe evidencat e raportuara në këtë raport, Grupi i Vetëvlerësimit konkludon se standartet për *fushën e mësimdhënies, mësimnxënies, vlerësimit dhe kërkimit plotësohen* **PLOTËSISHT.**

## 5. FUSHAT E VLERËSIMIT: STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| Studentët: Nga regjistrimi deri te punësimi |
| --- |
| **Institucioni ndjek një politikë korrekte për pranimin e studentëve të rinj.** *(Kreu I Standardi III.1)* UGJ ndjek një politikë korrekte për pranimin e studentëve të rinj, duke iu referuar kornizës ligjore në fuqi. Krahas kërkesave të përgjithshme, që burojnë prej ligjit dhe akteve nënligjore, UGJ është përzgjedhës në standardet e pranimit dhe aplikon po ashtu edhe kriteret e propozuara nga njësitë bazë dhe të miratuara me vendim senati [E1.59]. UGJ ofron programe gjithëpërfshirëse dhe në aplikimin e kritereve është i kujdesshëm që të ofrojë mundësi të njëjta si për studentët tradicionalë dhe për ata jotradicionalë. Ky qëllim theksohet edhe në Statutin [E1.1] dhe Strategjinë [E1.33] e UGJ-së. Në kuadër të Strategjisë së Ndërkombëtarizimit [E1.21], UGJ i ka dhënë rëndësi të veçantë edhe shkëmbimit të studentëve bazuar në programin ERASMUS, duke u vizituar kështu nga një numër i konsiderueshëm studentësh të huaj në cikle të ndryshme studimi, për çdo vit [E1.37], por edhe duke bërë të mundur përfitimin e një eksperience ndryshe për studentët e tij. Përveç studentëve që përfitojnë nga programet Erasmus, një kategori tjetër studentësh janë edhe studentët e huaj apo shqiptarë që kanë përfunduar ose kanë vazhduar studimet në një shtet tjetër. Afrimi i këtyre studentëve bëhet i mundur përmes procedurave të konvertimit të diplomave si dhe mundësisë së ekuivalentimit të lëndëve e parashikuar kjo sipas statutit [E1.1]. Në politikat e zhvillimit të UGJ theksohet rëndësia që ka ofrimi i një oferte didaktike të larmishme dhe e programeve multidisiplinare që lehtësojnë transferimin e studimeve por edhe mundësi për të ndjekur programe të shumëllojshme studimi të ciklit të dytë dhe të tretë. [E1.33]. UGJ, ka ngritur Sektorin e Shërbimeve Bibliotekare, Arkivore dhe Studentore si një strukturë përgjegjëse për informimin e studentëve të ardhshëm. Çdo vit ky sektor organizon ditët e hapura me maturantët, e cila ka për qëllim t'i informojë ata mbi programet e ofruara nga institucioni si dhe me facilitetet e tjera që UGJ ofron [E2.13]. Informimi i studentëve të ardhshëm bëhet edhe përmes takimeve informuese që realizohen nga zyra e këshillimit dhe karrierës së bashku me përfaqësues të stafit akademik të njësive bazë, çka i mundëson maturantët të marrin informacionin e nevojshëm mbi programet e ofruara [E2.12]. Informimi realizohet edhe përmes shpërndarjes së broshurave informuese të cilat paraqesin programet e ofruara nga Institucioni dhe vlerësohen se kanë një impakt më të gjatë në kohë dhe i shërbejnë si material plotësues ditëve të takimeve të hapura [E2.13]. Statusi i studentit në UGJ fitohet në momentin e regjistrimit të tij. Sapo studenti fiton këtë status, UGJ menjëherë vë në lëvizje mekanizmat pritës dhe integrues për |



REPUBLIKA E SHQIPERISË · UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

studentin duke i dhënë atij të njëjtin status me atë të studentëve të tjerë. Menjëherë studenti pajiset nga sekretaria mësimore me ID personale të tij. UGJ organizon takime mirëpritjeje me studentët që sapo e kanë fituar këtë status me qëllim orientimin e tyre jo vetëm mbi programet, por edhe mbi të gjitha facilitetet që UGJ ofron. Rregullorja e UGJ-së [E1.5] thekson rëndësinë e këshillimit akademik si një rol dhe mision i udhëheqjes profesionale dhe akademike. Studenti menjëherë me përfitimin e këtij statusi ka të drejtën të zgjedhi dhe të zgjidhet në organet përfaqësuese, ka të drejtën të marrë pjesë në workshope, trajnime, projekte, në biseda të hapura me stafin akademik, në dhënien e mendimit për çdo vendimarrje, që ndikon mbi statusin e tyre si student dhe në aktivitete të tjera të UGJ-së. Me qëllim realizimin e politikave të afrimit të maturantëve, UGJ mban lidhje me Drejtoritë Arsimore Rajonale mbi informimin e tyre, por edhe për realizimin e praktikave profesionale për programet e mësuesisë [E4.24].Gjithashtu këto lidhje shërbejnë edhe për realizimin e praktikave profesionale dhe punësimin e të diplomuarve. UGJ ka ngritur struktura të veçanta për pritjen, informimin dhe pranimin e studentëve të rinj. Këto struktura gjenden të vendosura në rektorat. Zyrat kryesore që realizojnë pranimin e studentëve të rinj është sekretaria mësimore si përgjegjëse për regjistrimin e studentëve në programet përkatëse të studimit, pajisjen e tyre me ID si dhe orientimin e tyre mbi facilitet e tjera që ofrohen [E5.1]. Çdo pedagog ka detyrimin e respektimit të një orari të caktuar pritje me studentët, gjatë të cilit ata mund të kërkojnë informacion apo asistencë, jo vetëm në lidhje me kursin përkatës, por edhe me programin apo me shërbime të tjera të ofruara nga institucioni [4.1]. Miratimi i Strategjisë së Ndërkombëtarizimit [E1.21] ka ardhur si rrjedhojë e orientimit të UGJ-së ndaj një përqasjeje të re, atë të hapjes së institucionit duke lehtësuar mundësinë e përthithjes dhe integrimit të studentëve të huaj, mundësi kjo e parashikuar edhe në Rregulloren e UGJ-së[E1.5]. Në kuadër të kësaj strategjie UGJ synon të ndjekë një politikë të afrimit dhe mirëpritjes së studentëve të huaj dhe synon nxitjen e mobiliteteve të studentëve të huaj, përmes marrëveshjeve ndërinstitucionale. Kjo, arrihet jo vetëm përmes marrëveshjeve të UGJ-së në kuadër të programeve Erasmus [E1.36], por edhe lehtësimit të procedurave të pranimit dhe integrimit të studentëve të huaj përmes procedurave të njohjes dhe ekuivalentimit të diplomave në periudha të studimit[E3.40]. Rregullorja e UGJ-së[E1.5] përcakton si detyrim për të gjithë personelin akademik, që për një numër të arsyeshëm orësh, çdo javë duhet të jetë në dispozicion të studentëve për konsultim në zyrën e vet [E5.3]. Pedagogu ka detyrimin ti bëj të njohura këto orare pranë sekretarisë mësimore ose ti komunikojë ato gjatë zhvillimit të kursit. Oraret e pritjes me studentët për çdo pedagog afishohen në stendën e njoftimeve pranë çdo departamenti. Politikave të pranimit të studentëve i përgjigjet edhe një staf akademik i mirëplanifikuar bazuar në standarde. Qëllimi i UGJ është të garantojë standarde të larta të mësimdhënies edhe duke patur parasysh raportin student/pedagog

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

| |
|---|
| Ky raport për çdo fakultet vijon si në tabelat e pasqyruara[E5.2]. |
| **Institucioni ndjek një politikë të informimit të studentëve dhe siguron komunikimin ndërmjet tyre dhe personelit akademik.** *(Kreu I Standardi III.2)*<br>Pranimi i studentëve realizohet nga dy struktura kryesore të vendosura në Rektorat dhe nga disa të tjera të vendosura pranë njësive bazë. Zyra e Këshillimit të Karrierrës dhe Alumnit është zyra që këshillon studentët rreth regjistrimit, të drejtave dhe detyrimeve që u lindin nga përfitimi i statusit të studentit, rregulloren dhe statutin e universitetit, lëndët që mund të përzgjedhin, aspektet financiare dhe aktivitet shkencore dhe kulturore brenda UGJ-së. Zyra e IT-së, po ashtu e vendosur pranë Rektoratit është përgjegjëse për krijimin, menaxhimin dhe administrimin e llogarisë personale të çdo studenti, prej nga e cila studenti informohet mbi procesin mësimor. Më tej sekretaritë mësimore janë zyrat që realizojnë regjistrimin dhe informimin e tyre mbi programet e lëndëve dhe aktivitetet e tjera që organizohen nga njësia bazë [E5.1]. Komunikimi dhe informimi në UGJ realizohet përmes publikimeve në faqen zyrtare www.uogj.edu.al. Publikimi i dokumentave të rëndësishëm të UGJ-së si dhe aktiviteteve të saj bën më të aksesueshëm informacionin, jo vetëm nga stafi dhe studentët, por edhe nga të tretët, që janë të interesuar të informohen rreth UGJ-së. Në përpjekje për të rritur aksesin dhe informimin, UGJ është po ashtu aktive edhe në mediat sociale përmes adresave në *facebook* dhe *instagram.* Po ashtu edhe për të gjithë ata që kërkojnë një informacion zyrtar.<br>UGJ disponon mjete shkresore të komunikimit si dokumentat shkresore të protokolluara [E2.39], si dhe të pajisura me firmën e autoritetit drejtues, vulën dhe logon e Institucionit. Si mjete për të realizuar komunikimin e jashtëm shërbejnë edhe telefonatat, email dhe tele-konferencat. Krahas formave të jashtme të komunikimit edhe mjetet e komunikimit të brendshëm janë të larmishme. Komunikimi i brendshëm mund të realizohet përmes akteve dhe njoftimeve shkresore me shpërndarjen e tyre tek organet, autoritetet drejtuese apo të gjithë personelit akademik dhe administrativ përkundrejt nënshkrimit përkatës mbi marrjen në dijeni. Komunikimi i brendshëm mund të jetë edhe verbal, për çështje, natyra e të cilave e mundëson këtë lloj komunikimi. Për komunikimin e brendshëm, UGJ përdor edhe komunikimin virtual përmes emailit, njoftimet dhe komunikimet në "Këndin e Njoftimeve" kryesisht për studentët, si dhe përmes faqes zyrtare të UGJ www.uogj.edu.al si dhe rrjetit të brendshëm telefonik të UGJ-së[E2.28]. Rregullorja e UGJ-së [E1.5] përcakton mënyrën e komunikimit të punonjësve të institucionit. Sipas përcaktimeve respektive komunikimi dhe njoftimet e çdo lloji drejtuar personelit akademik dhe personelit të institucionit realizohet edhe përmes postës elektronike zyrtare shkronja e parë |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| |
|---|
| emër.mbiemër@uogj.edu.al si dhe përmes publikimit në faqen zyrtare të internetit www.uogj.edu.al [E2.28]. Faqja zyrtare dhe adresa elektronike, bazuar në Rregullore [E1.5], mirëmbahet dhe përditësohet nga Zyra e IT-së. Bazuar në Rregulloren e UGJ-së [E1.5], dosja personale dhe të dhënat personale të çdo studenti administrohen nga sekretaria mësimore, e cila është e detyruar të administrojë dhe përditësojë vazhdimisht dosjen e çdo studenti nga momenti, që ai merr një status të tillë [E2.79]. Administrimi përfshin të dhënat personale të tyre, vlerësimet e marra gjat ndjekjes së programit të studimit, të dhëna mbi diplomën ose diplomat e marra, bashkë me suplementin e diplomës sipas regjistrave përkatës. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për administrimin me përgjegjshmëri të të dhënave [E2.79] duke marrë në konsideratë detyrimin mbi mbrojtjen e të dhënave personale, bazuar edhe në Rregulloren e Mbrojtjes së të Dhënave Personale [E2.53]. Administrimi i të dhënave bëhet edhe në regjistra elektronike, sipas përcaktimeve në rregulloren e sekretarisë mësimore. [E2.55]. Sekretaritë mësimore përgjegjëse për administrimin e të dhënave personale të studentit disponojnë adresën elektronike të studentit shkronje e pare emër mbiemër@uogj.edu.al e cila shërben si një formë komunikimi midis institucionit dhe studentit, por në formularin e regjistrimit [E2.55] të studentit disponohet edhe adresa personale e emailit si dhe numri i telefonit, i cili mund të përdoret në raste kur ka nevojë për njoftime urgjente apo nëse studenti nuk e ka marrë njoftimin elektronik. |
| **Institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të studentëve.** *(Kreu I Standardi III.3)*<br>UGJ i jep një rëndësi orientimi dhe këshillimit të studentëve të vet. Merr përsipër orientimin e studentëve për çdo zgjedhje apo aplikim, që lidhet me programe e studimit.<br>UGJ synon t'i japë prioritet studentëve të vet, në vazhdimin e cikleve të mëtejshme të studimit [E5.17]. Zyra e Këshillimit të Karrierrës dhe Alumnit angazhon studentët në trajnime dhe ofron informacion mbi mënyrën e përgatitjes për tregun e punës, përgatitjen e CV-së personale, panairet e punës dhe mundësi të ndryshme punësimi, mbi programet e studimit dhe mundësitë për të kaluar nga një program studimi në një tjetër brenda apo jashtë UGJ-së, mbështetje dhe këshillim për aplikimet,për vazhdimin e ciklit të studimit ose të cikleve të tjera të studimit në Institucione të arsimit të lartë jashtë vendit [E5.24]. UGJ i ka riorganizuar programet e studimit në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë. Bazuar në këtë riorganizim programet synojnë adaptimin progresiv të studentit duke ofruar fillimisht lëndë të formimit të përgjithshëm, lëndë ndërdisiplinore si dhe lëndë karakterizuese e lëndë plotësuese në përqindjet e përcaktuara me VKM.<br>Një ndër format e informimit të studentëve, e përdorur nga strukturat e UGJ-së është edhe ajo e shpërndarjes së materialeve informuese. Zyra e Këshillimit të Karrierrës dhe Alumnit përgatit dhe |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| |
|---|
| shpërndan broshura informuese për programet e studimit që ofrohen nga UGJ, por edhe për shërbimet e tjera[E2.11]. Gjithashtu, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit zhvillon aktivitete të ndryshme informuese me studentët, ku krahas të qënit pjesëmarrës ata pajisen edhe me materialet e nevojshme informuese [E2.12,2.13]. |
| ›arashikon mundësinë e ndryshimit të programit të studimit përmes procedurës së transferimeve brenda dhe jashtë institucionit me kushtin, që transferimi të bëhet në programe të përafërta studimi [E1.1, E1.5]. Sipas përcaktimeve në Statut dhe Rregullore, transferimi në programe të përafërta studimi është i mundur si për studentët brenda UGJ ashtu edhe në Institucione të tjera të arsimit të lartë. Të drejtën për transferim e kanë vetëm studentët që kanë siguruar të paktën 30 kredite . Procedura e transferimit realizohet përmes Komisionit *ad'hoc* të ngritur në njësitë kryesore e bazë, të cilat kontrollojnë programin dalës të studimit dhe atë në të cilin studenti kërkon të aplikojë. Komisioni i Ekuivalentimit, i ngritur pranë Njësisë Bazë realizon njësimin e lëndëve dhe përcakton detyrimet, që studenti ka për të shlyer. Lista e aplikuesve përcillet në Rektorat dhe miratohet nga Rektori [E3.41]. UGJ mbështet studentët e tij në të gjitha ciklet e studimeve që ofrohen[E1.5]. Zyra e Këshillimit të Karrierrës dhe Alumnit orienton dhe këshillon studentët përgjatë të gjitha cikleve të studimit, si dhe përgjatë kalimeve nga cikli i parë i studimit në ciklin e dytë dhe të tretë [E5.24]. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit orienton studentët për daljen e tyre në tregun e punës dhe i ndjek ata edhe pas përfundimit të studimeve [E5.23]. |
| **Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta.** *(Kreu I Standardi III.4)*<br>Në përputhje me legjislacionin në fuqi, UGJ ofron mbështetje për uljen apo heqjen e plotë të tarifës së studimit [E5.25]. UGJ krijon për studentët me aftësi të kufizuara të gjitha lehtësitë e nevojshme për ndjekjen e proçesit mësimor në mënyrë të rregullt. Në godinën B janë ndërtuar rampat për të rritur aksesin e studentëve me aftësi të kufizuar [E5.4]. Në klasat ku ka student të tillë mësimi të zhvillohet në katin e parë. Në rastin e studentëve shurdh- memec, apo të studentëve të verbër çdo pedagog në kursin e tij ofron mundësinë e realizimit të vlerësimit të dijeve në mënyrën e përshtatshme për studentin [E5.4]. UGJ ndjek politika mbështetëse edhe për studentët me prejardhje nga minoritete të ndryshme (p.sh romë dhe ata ballkano-egjiptian) [E5.5]. Legjislacioni në fuqi përcakton kategoritë e studentëve, që do të përjashtohen apo të cilëve mund t'u reduktohen tarifat e shkollimit, përfshin në këtë kategori edhe grupe të tjera si jetimët, fëmijët e ish- të dënuarve apo të përndjekurve politikë, fëmijët e policëve apo ushtarakëve të Forcave të Armatosura, që kanë humbur jetën ose janë plagosur për shkak të detyrës. Njësitë bazë të UGJ-së propozojnë për këto kategori studentësh, të trajtohen sipas VKM, nr. 40, datë 23.01.2019 dhe |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| |
|---|
| sipërcituar). Institucioni mbështet studentët që angazhohen në aktivitete sportive apo kulturore të niveleve të larta, jo vetëm përmes promovimit të këtyre aktiviteteve, por edhe duke krijuar lehtësitë e nevojshme për këta student. Studentët e përfshirë në këto aktivitete, me kërkesë të tyre dhe miratim të Dekanit, mund të realizojnë vlerësimin e njohurive në një moment të ndryshëm nga ai i vlerësimit të pjesës tjetër të klasës [E5.22]. UGJ nuk bën pranime në programe studimi me kohë të pjesshme, por vazhdon t'u ofroj mundësinë studentëve, që janë në mbyllje të këtyre programeve të studimit [E5.7]. |
| **Institucioni ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët.** *(Kreu I Standardi III.5)*<br>UGJ garanton për studentët e tij, jo vetëm tekstet mësimore bazë por edhe literaturën plotësuese të nevojshme të rekomanduar dhe miratuar nga çdo departament [E4.4]. Tekstet mësimore që u ofrohen studentëve janë tekste të përzgjedhura, të cilat plotësojnë standardet e nevojshme për t'u përdorur si tekste universitare. Fondi i literaturës bazë dhe asaj të rekomanduar gjendet pranë Bibliotekës së Universitetit [E4.4]. Kësaj shumëllojshmërie librash të gjendur në hard copy i është shtuar edhe larmishmëria e literaturës që studentët mund të aksesojnë përmes bibliotekës *online* https://ulibrary.rash.al/. Aksesi në këtë bibliotekë realizohet përmes adresës së universitetit me të cilën çdo student pajiset në momentin që fiton këtë status në UGJ. UGJ-ja ka një strukturë të posaçme, që shërben për ruajtjen e dokumentacionit të lidhura me tekstet mësimore dhe me literaturën e përdorur. Biblioteka Shkencore e UGJ [E5.8] ka për qëllim koordinimin e nevojave të pedagogëve dhe të studentëve si dhe kryen procedurën e regjistrimit të librave, broshurave dhe revistave.Gjithashtu Sektori i Standarteve dhe Kurrikulave mban një listë të gjerë të literaturës që vihet në dispozicion nga Biblioteka Shkencore. UGJ ka një Bibliotekë Qëndrore, e cila ndodhet në godinën C të Universitetit, të pajisur me një literaturë të pasur dhe me ambiente komode. Përveç bibliotekës qëndrore, dy biblioteka të tjera janë vendosur pranë Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore. Çdo vit, përpara miratimit të buxhetit, departamentet paraqesin projektpropozimet e tyre, që përfshijnë edhe nevojën për literaturën bazë apo literaturë shtesë [E4.6]. Edhe Biblioteka paraqet kërkesat e saj për pasurimin e fondit të saj në çdo fillim viti akademik, duke kërkuar të ketë një zë përkatës në buxhet [E4.6 ]. Përveç pasurimit periodik që realizohet me fondet e UGJ-së, literatura e bibliotekës pasurohet edhe përmes donacioneve të miqve të UGJ-së[E4.7]. Propozimet e secilës Njësi bazë miratohet sipas procedurave përkatëse të Institucionit [E4.5]. Literatura e ofruar, përmes Bibliotekës është multidisiplinare. Në bibliotekë gjenden tituj nga 10 fusha të ndryshme studimi, Të interesuarit gjejnë në Bibliotekë literaturë për çështje të përgjithshme, për shkencën dhe diturinë, për filozofinë, psikologjinë, shkencat shoqërore dhe nëndarjet e tyre, ekonominë dhe nëndarjet e saj, drejtësinë, matematikën dhe shkencat e natyrës, shkencat e aplikuara si mjekësia dhe teknologjia, linguistika dhe letërsia, |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| |
|---|
| historia, gjeografia, si dhe materiale që trajtojnë artin, kulturën dhe sportin. Studenti disponon një kartelë regjistrimi, përmes të cilës siguron literaturën. Kartela e regjistrimit përmban informacionin e dhënë si më poshtë: Numrin e kartelës, emër, mbiemër, atësi dhe datëlindje, fakulteti ku studion, numri i telefonit, adresa e banimit, numri i letërnjoftimit, si dhe nënshkrimi i përgjegjësit të bibliotekës dhe lexuesit [E5.9]. Biblioteka vetë nuk e ofron shërbimin *e-book*, por ndërkohë stafi dhe studentët kanë mundësinë të aksesojnë në bibliotekën *online* dhe të sigurojnë një shumëllojshmëri literature në gjuhë të huaj. |
| **Institucioni u ofron studentëve mbështetje nëpërmjet shërbimeve universitare për të lehtësuar ecurinë e tyre.** *(Kreu I Standardi III.6)*<br>UGJ ofron për studentët udhëheqje dhe kujdestari (tutorat). Kjo realizohet gjatë fazës së punimit të temave të diplomës nga studentët në të gjitha ciklet e studimeve. Procedura të qarta të shpërndarjes së udhëheqjeve të temave të diplomës parashikohen nga UGJ, në bazë të rregullores së programeve të studimit.<br>UGJ ndihmon dhe orienton studentin për mënyrën e sigurimit të literaturës. Kjo gjë realizohet nga vetë pedagogët e lëndës apo dhe nga departamenti përkatës i programit mësimor.<br>UGJ nuk ofron kurse për të ndihmuar studentët në vështirësi, por zhvillohen konsultime me pedagogët sipas nevojave që kanë studentët, të planifikuara në programet mësimore, përveç konsultimeve të parashikuara në programet disiplinore. Senati Akademik me vendimin nr. 05, date 02.02.2021, ka miratuar ngritjen e Qendrës Ndërdisiplinore te Kerkimit Shkencor **(E4.25)** |
| **Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale.** *(Kreu I Standardi III.7)*<br>Studentët inkurajohen në pjesëmarrjen në jetën institucionale. Ata përfaqësohen ose janë pjesë në organe në nivel institucional dhe gjithashtu në organe në nivel njësie kryesore. Senati Akademik i UGJ-së ka në përbërje 2 studentë senatorë, të cilët zgjidhen nga vetë studentët. Studentët janë pjesëmarrës në komisionet epërhershme në nivel institucioni si dhe në komisionet e njësive kryesore[E1.28].Studentët marrin pjesë në procese të rëndësishme të jetës institucionale dhe akademike, duke qenë anëtarë të komisioneve zgjedhore institucionale dhe në njësi kryesore[E.1.27].Studentët organizohen lirisht në Këshillat Studentorë, institucionalë dhe në njësitë kryesore. Ndër të tjera, studentët janë pjesë e hartimit të raporteve të rëndësishme institucionale, si Raporti i Vlerësimit të Brendshëm Institucional. Janë pjesë aktive e sontazhit vjetor të studentëve organizuar nga ASCAL dhe e sontazheve organizuar nga institucioni.<br>Senatorët studentë të Senatit Akademik në UGJ shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm, si për planet mësimore dhe programet e studimeve, rregulloret e studimeve etj. Ky mendim merret drejtpërdrejt nga takimet me studentët ose |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

nëpërmjet kutisë së ankesave. UGJ mbështet organizimin e studentëve dhe financon veprimtarinë e tyre, sipas mundësive financiare të UGJ [E2.26]

**Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për të siguruar cilësinë e jetës studentore.** *(Kreu I Standardi III.8)*

UGJ përpiqet të sigurojë cilësinë e jetës studentore përmes veprimtarive të ndryshme që ai ofron. Është arritur implementimi i Kartës së Studentit si detyrim ligjor dhe pjesë e Paktit për Universitetin. UGJ mbështet studentët në aktivitetet e tyre, promovon studentët më të mirë, realizon ceremonitë e diplomimit, si dhe aktivitete të tjera që synojnë zgjerimin e fushës së informacionit tek studentët përmes projekteve apo seminareve[E3.42]. UGJ zhvillon një larmishmëri të aktiviteteve sportive dhe kulturore me mbështetjen e institucionit. Është krijuar shoqata sportive e UGJ, me një aktivitet të pasur sportiv me pjesëmarrje dhe në evente ndërkombëtare sportive si Lojrat Universitare PCU në Antwerp Belgjikë[E5.26]. Institucioni mbështet edhe çdo inisiativë që lidhet me aktivitete kulturore dhe sportive si psh realizimi i shfaqeve teatrale nga studentët, duke u dhënë mundësinë për të patur të gjitha llojet e faciliteteve për ushtrimin e aktivitetit të tyre si financimi i grupit të futbollit nga fondet e UGJ-së [E2.26]. UGJ bashkëpunon me strukturat shëndetësore, jo vetëm në realizimin e praktikave profesionale të studentëve por edhe përmes aktiviteteve që zhvillohen me qëllim ndërgjegjësimin e popullatës dhe motivon studentët e tij. Anëtarësimi në Shoqatën Kombëtare Sportive Universitare vendimi përkatës.

**Institucioni favorizon punësimin e studentëve.** *(Kreu I Standardi III.9)*

Përmes Sektorit të Shërbimeve Bibliotekare, Arkivore dhe Studentore, UGJ disponon të dhënat statistikore për punësimin e të diplomuarve të vet [E5.15].UGJ u ofron ndihmë studentëve përmes trajnimeve që Zyra e Këshillimit të Karierrës organizon në lidhje me mënyrat e aplikimit për punësim, hartimin e një kurrikulumi, sjelljen gjatë një interviste pune etj, por edhe përmes vetë aktiviteteve që ai organizon si panairi i punës, etj[E5.24]. Rritja e kapaciteteve të studentëve dhe përgatitja e tyre për punësim realizohet jo vetëm si më sipër, por edhe përmes takimeve që realizohen me grupet e interesit [E5.23] si dhe përmes realizimit të praktikave profesionale nën udhëheqjen e pedagogëve. Të dyja u ofrojnë mundësinë studentëve të njihen nga punëdhënës të ndryshëm, duke krijuar kështu mundësinë e kontakteve. Në rastin e praktikave profesionale studenti pajiset edhe me aftësi praktike që i lehtësojnë atij daljen në tregun e punës. UGJ mban marrëdhënie me studentët Alumni duke synuar të mbetettërheqës, si dhe favorizues në procesin e punësimit të të diplomuarve të vet. Gjithashtu, UGJ gjurmon ish-studentët [E5.16] e tij duke krijuar kështu mundësinë e kontakteve të vazhdueshme dhe i fton ata sa herë UGJ organizon takime informuese apo formuese me aftësimin profesional apo daljen në tregun e punës [E5.24].



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

| |
|---|
| Trajnimet e vazhdueshme, por edhe mbajtja e kontakteve lehtësojnë procesin e hyrjes në tregun e punës. UGJ-ja, nuk ka një politikë të mirëfilltë për punësimin e të diplomuarve të vetë, por ajo ndjek dhe inkurajon punësimet e të dplomuarëve të saj. Brenda UGJ, një numër i madh i stafit akademik dhe administrativ janë ish-student në të paktën një cikël studimit në UGJ [E5.15]. |
| **<u>Përfundimet dhe Vlerësimi</u>**<br>UGJ u ka dhënë një rol të rëndësishëm studentëve duke i trajtuar ata si përfituesit kryesorë të tij dhe duke krijua infrastrukturën e nevojshme për ta. UGJ ndjek një politikë promovuese duke synuar të afrojë studentë, jo vetëm vendas, por edhe të huaj përmes ofertës së larmishme didaktike . Nga momenti i regjistrimit e deri në përfundim të studimeve, studentët përfitojnë nga shërbimet didaktike, sociale dhe kulturore që UGJ ofron. Në UGJ studentët nuk janë vetëm në rolin e përfituesit të shërbimeve. Përmes strukturave përfaqësuese të tyre ata ndikojnë në gjithë procesin e vendimarrjes dhe politikëbërjes së UGJ. Mbështetja e strukturave të UGJ-së për të nxitur vetëorganizimin e studentëve është një reflektim mbi konkluzionet e GVJ të 2017, duke sjellë edhe përmbushjen e një kriteri të rëndësishëm. Shërbimet e ofruara nga UGJ synojnë të jenë në përshtatshmëri dhe konformitet me kërkesat dhe veçoritë e secilit student. Në këtë kuptim zyrat e këshillimit dhe pedagogët janë në dispozicion të studentëve, duke i orientuar ata drejt zgjedhjeve më efikase për karrierën e tyre akademike dhe përfshirjen në aktivitetet sociale, kulturore dhe sportive. Duke marrë parasysh kriteret e përmbushura si dhe reflektimin pozitiv ndaj orientimeve të raportit të GVJ 2017, mbi përfshirjen e studentëve në jetën e universitetit dhe në politikat qeverisëse të tij, Grupi i vetëvlerësimit konkludon se në UGJ *standartet për fushën e studentëve dhe mbështetjes së tyre përmbushen* **<u>Plotësisht.</u>** |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

## Përfundimet dhe vlerësimi përgjithshëm

UGJ nëpërmjet proçesit periodik të akreditimit institucional synon tu përgjigjet tendencave të zhvillimit të institicionit dhe tregut të punës të cilat janë në ndryshim të vazhdueshëm. Kërkesat për performancë më të mirë në mësimdhënie dhe në përgatitjen e studentëve të aftë për tregun e punës janë në rritje. Hartimi dhe zhvillimi i një skeme për trajnimin e vazhdueshëm të stafit akademik, bashkëpunimi dhe ndërkombëtarizimi i UGJ-së me rritjen e mobiliteteve dhe numrin e aplikimeve dhe thithjes së fondeve të huaja, vendim marrja pas diskutimit dhe debatit konstruktiv të çdo propozimi dhe mendimi, përmirësimi i dukshëm në fushën e burimeve njerëzore janë rezultate të menaxhimit efikas të institucionit. Në UGJ menaxhimi financiar nëpërmjet politikave financiare transparente kryhet në përputhje me kuadrin dhe procedurat ligjore të përcaktuara. Sistemi i Menaxhimit Mësimor ESSE3 i instaluar në UGJ, mbështet dhe lehtëson funksionimin e proçedurave akademike, administrative dhe dixhitalizimin e të dhënave. Infrastruktura logjistike dhe fizike është në përmirësim të vazhdueshëm. Programet e studimit organizohen për të përmbushur standartet kombëtare të cilësisë, duke respektuar në formë dhe përmbajtje kërkesat që burojnë nga aktet ligore dhe nënligjore. Përmbajtja e programeve të studimit të ofruara synon të përmbushë skenarin e lidershipit profesional të parashikuar në planin strategjik të zhvillimit institucional. Programet e studimit hartohen që të lehtësohet mobiliteti i studentëve brenda dhe jashtë vendit. Përmirësimi i vazhduar i tyre kryhet duke marrë në konsideratë nevojat dhe kërkesat e tregut të punës. UGJ ka instaluar një sistem efektiv për zbatimin në kushte të përshtatshme të programeve të studimit që ofron. Në përmbushje të rekomandimeve të RVJ (Maj 2017), për përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, UGJ ka instaluar tashmë një skemë efektive nëpërmjet miratimit të strategjisë së integrimit dhe trajnimit të stafit të ri të rekrutuar, strategjisë për trajnimin e vazhdueshëm të kërkuesve të rinj dhe udhëzuesit për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies. UGJ ka një strategji të kërkimit shkencor dhe stafit akademik i siguron mundësitë që veprimtaria kërkimore shkencore të kryhet në përputhje me standartet e pranuara kombëtare dhe ndërkombëtare. Institucioni u ka dhënë një rol të rëndësishëm studentëve duke i trajtuar ata si përfituesit kryesor të tij nëpërmjet krijimit të infrastrukturës së nevojshme për ta. Nga momenti i regjistrimit e deri në përfundim të studimeve, studentët përfitojnë nga shërbimet didaktike, sociale dhe kulturore që UGJ ofron. Studentët nuk janë vetëm në rolin e përfituesit të shërbimeve por përmes strukturave përfaqësuese të tyre ata ndikojnë në gjithë procesin e vendimmarrjes dhe politikbërjes së UGJ. Mbështetja e strukturave të tij për të nxitur vetëorganizimin e studentëve është një reflektim mbi konkluzionet e GVJ të 2017 duke sjell edhe përmbushjen e një kriteri të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

rëndësishëm. Duke qënë se universitetet luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e burimeve njerëzore, kulturës dhe shkencës, UGJ ka punuar maksimalisht për të plotësuar mangësitë/dobësitë/rekomandimet e GVJ. Në këtë kontekst UGJ është i ndërgjegjshëm se përmbushja e nevojave edukative në nivel kombëtar dhe global sigurohet nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së proçesit arsimor dhe të programeve të studimit

Bazuar mbi përfundimet dhe vlerësimet e secilës prej fushave të analizuara në raport, gjykimi i përmbledhur sipas fushave, për Përmbushjen e Standarteve Shtetërore të Cilësisë, *është si më poshtë vijon*:

| **Fusha** | **Vlerësimi** |
|---|---|
| Organizimi dhe Menaxhimi i Institucionit | *Standartet përmbushen* **Plotësisht.** |
| Burimet | *Standartet përmbushen* **Kryesisht.** |
| Kurrikulat | *Standartet përmbushen* **Plotësisht.** |
| Mësimdhënia , Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi | *Standartet përmbushen* **Plotësisht.** |
| Studentët dhe mbështetja e tyre | *Standartet përmbushen* **Plotësisht.** |



REPUBLIKA E SHQIPERISE • UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" • GJIROKASTËR

## Lista e evidencave mbështetëse të IAL-së

(Të renditura në përputhje me fushat dhe sikurse janë referuar në raportin e vetëvlerësimit)

### 1 –FUSHA E VLERËSIMIT: ORGANIZIMIN DHE MENAXHIMI I INSTITUCIONIT

| Nr. Evidencës | Titulli |
|---|---|
| **Evidenca 1.1** | Statuti UGJ |
| **Evidenca 1.2** | Vendimi i Senatit Akademik për Miratimin e Statutit |
| **Evidenca 1.3** | Vendimi i KA për Miratimin e Statutit |
| **Evidenca 1.4** | Rregullore e UGJ |
| **Evidenca 1.4.1** | Vendimi i Senatit Akademik për Miratimin e Rregullores |
| **Evidenca 1.5** | Rregullore e përditësuar e UGJ |
| **Evidenca 1.5.1** | Vendimi i Senatit Akademik për Miratimin e Rregullores së përditësuar |
| **Evidenca 1.5.2** | Vendimi i Bordit të Administrimit për Miratimin e Rregullores së përditësuar |
| **Evidenca 1.6** | Rregullore FESHSH |
| **Evidenca 1.6.1** | Vendim Miratim Rregullore FESHSH (Vendim i Njesise Kryesore) |
| **Evidenca 1.7** | Rregullore FSHN |
| **Evidenca 1.7.1** | Vendim Miratim Rregullore FSHN (Vendim i Njesise Kryesore) |
| **Evidenca 1.8** | Rregullore FE |
| **Evidenca 1.8.1** | Vendim Miratim Rregullore FE (Vendim i Njesise Kryesore) |
| **Evidenca 1.9** | Rregullore e Departamentit të DEMM |
| **Evidenca 1.10** | Rregullore e Departamentit të Matematikes Informatikes dhe Fizikes |
| **Evidenca 1.11** | Rregullore e Departamentit të Administrimit Publik |
| **Evidenca 1.12** | Rregullore e Senatit Akademik |
| **Evidenca 1.12.1** | Vendim SA, Nr.26 date 08.09.2020 për miratimin e Rregullores së Senatit Akademik |
| **Evidenca 1.13** | Vendim SA. Nr.38. datë 20.12.2016 për miratimin e përfaqësuesve në BA<br>Vendim SA. Nr.08. datë 18.03.2019 për miratimin e përfaqësuesve në BA |
| **Evidenca 1.13.1** | Urdhëra MASR për emërimin e përfaqësuesve në BA |
| **Evidenca 1.14** | Struktura Organizative e UGJ |
| **Evidenca 1.14.1** | Vendimi i SA Nr.12 datë 05.02.2020 "Për miratimin e strukturës Organizative" të UGJ |
| **Evidenca 1.14.2** | Vendimi i BA Nr.12 datë 07.02.2020 "Për miratimin e strukturës Organizative" të UGJ |



REPUBLIKA E SHQIPERISE · UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| **Evidenca 1.15** | Vendime Miratimi SA Buxheti i UGJ 2019, 2020 |
| **Evidenca 1.15.1** | Vendime Miratimi BA Buxheti i UGJ 2019, 2020 |
| **Evidenca 1.16** | Plani i Aktiviteteve të UGJ 2019-2020 |
| **Evidenca 1.16.1** | Vendimi SA Nr.30. datë 20.12.2019 "Për miratimin e Planit të Aktiviteteve të UGJ 2019-2020 |
| **Evidenca 1.17** | Shkresat përcjellëse për Veprimtarinë mësimore shkencore dhe financiare 2018, 2019, 2020 |
| **Evidenca 1.18** | Karta dhe Kodi Europian për Kërkuesit |
| **Evidenca 1.19** | Rregullore e Doktoraturës |
| **Evidenca 1.20** | Lista e konferencave, numri i artikujve/buletini |
| **Evidenca 1.21** | Strategjia e Ndërkombëtarizimit të UGJ |
| **Evidenca 1.22** | Rregullore e Bordit të Administrimit |
| **Evidenca 1.23** | Vendim për ngritjen e Këshillit të Etikës |
| **Evidenca 1.24** | Kodi i Etikës dhe vendimi SA për miratimin e Kodit të Etikës |
| **Evidenca 1.25** | Kriteret dhe Standartet antiplagjiaturë (shtojca) |
| **Evidenca 1.26** | Shembuj vendimesh Dekanati |
| **Evidenca 1.27** | Rregullore e zgjedhjeve të 2020 |
| **Evidenca 1.27.1** | Vendim SA. Nr.13. datë 07.02.2020 mbi miratimin e Rregullores e zgjedhjeve të 2020 |
| **Evidenca 1.28** | Vendimet e KIZ 2020 |
| **Evidenca 1.29** | Emërimet nga zgjedhjet e fundit per autoritetet dhe organet drejtuese te UGJ-se |
| **Evidenca 1.30** | Vendimi SA Nr 38 datë 09.12.2020 dhe Urdhër i Rektoratit Nr.99 datë 11.12.2020 i ngritjes së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, urdher i Rektorit nr. 06 date 16.02.2021 |
| **Evidenca 1.31** | Rregullore e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë |
| **Evidenca 1.32** | Lista e Honoris Causa Vendimet e SA respektive |
| **Evidenca 1.33** | Strategjia e Zhvillimit të UGJ |
| **Evidenca 1.33.1** | Vendimi SA Nr.29. datë 20.12.2020 për miratimin e Strategjisë së Zhvillimit të UGJ |
| **Evidenca 1.34** | Lista projekteve të fituara 2018-2019-2020 |
| **Evidenca 1.35** | Lista e marrëveshjeve me jashtë |
| **Evidenca 1.36** | Lista e marrëveshjeve KA1 |
| **Evidenca 1.37** | Lista e mobiliteteve të studentëve |
| **Evidenca 1.38** | Lista e mobiliteteve të pedagogëve |
| **Evidenca 1.39** | Lista e mobiliteteve të stafit ndihmësakademik dhe administrativ |
| **Evidenca 1.40** | Raporti Vjetor 2018-2019 |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| **Evidenca 1.40.1** | Vendim miratimi i raportit vjetor nga SA /BA 2018 |
| **Evidenca 1.41** | Raporti Vjetor 2019-2020 |
| **Evidenca 1.41.1** | Vendim miratimi i raportit vjetor nga SA /BA 2019 |
| **Evidenca 1.42** | Programet akademike sipas emërtimit dhe fakultetit |
| **Evidenca 1.43** | Strategjia e Kërkimit Shkencor |
| **Evidenca 1.44** | Strategji Zhvillimi FESHSH |
| **Evidenca 1.45** | Strategji Zhvillimi FSHN |
| **Evidenca 1.46** | Strategji Zhvillimi FE |
| **Evidenca 1.47** | Strategji Zhvillimi Departamentet e UGj-se |
| **Evidenca 1.48** | Laboratorët |
| **Evidenca 1.49** | Lista e pedagogëve të UGJ + gradat |
| **Evidenca 1.50** | Lista e pedagogëve të FESHSH + gradat |
| **Evidenca 1.51** | Lista e pedagogëve të FSHN + gradat |
| **Evidenca 1.52** | Lista e pedagogëve të FE + gradat |
| **Evidenca 1.53** | Lista e pedagogëve të UGJ me kohë të pjesshme/ të ftuar + gradat |
| **Evidenca 1.54** | Vendim SA Nr 27. Datë 08.09.2020 për Komisionet e përhershme |
| **Evidenca 1.55** | Relacion i Panairit të punës 2019 |
| **Evidenca 1.56** | Gjurmimi i Alumnit (Procedurë e plotë) |
| **Evidenca 1.57** | Komunikimi me Alumni |
| **Evidenca 1.58** | Database alumni 2019- 2020 |
| **Evidenca 1.59** | Vendim SA. Nr. 14 datë 11.07.2019 për miratimin e kritereve dhe kuotave të pranimit 2019-2020 |
| **Evidenca 1.60** | Vendime BA për miratim tarifash të studentëve 2018-2020 |
| **Evidenca 1.61** | Listë aktivitetesh bashkëpunimi 2017-2020 |
| **Evidenca 1.62** | Lista e partnerëve te brendshëm që bashkëpunojmë |
| **Evidenca 1.63** | Marrëveshje bashkëpunimi me organizatat dhe shoqatat ku UGJ është anëtarësuar |
| **Evidenca 1.64** | Rregullore Erasmus |
| **Evidenca 1.65** | Guida Erasmus |



REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

## 2 – FUSHA E VLERËSIMIT: BURIMET

| Nr. Evidencës | Titulli |
|---|---|
| Evidenca 2.1 | Rregullore për punësimin e stafit akademik dhe administrativ në UGJ |
| Evidenca 2.2 | Organograma Rektorat UGJ 2020 |
| Evidenca 2.3 | Organograma FESHSH 2020 |
| Evidenca 2.4 | Organograma FSHN 2020 |
| Evidenca 2.5 | Organograma FE 2020 |
| Evidenca 2.6 | Lista e pedagogëve të jashtëm që angazhohen në programet të ndryshme të studimit |
| Evidenca 2.7 | Lista e pedagogëve të jashtëm që angazhohen në programet e studimit të ciklit të dytë shoqëruar me fushën e punësimit me kohë të plotë të tyre |
| Evidenca 2.8 | Lista e personelit ndihmësakademik dhe administrativ; |
| Evidenca 2.9 | Procedurë e plotë punësimit të stafit akademik |
| Evidenca 2.10 | Vendim Rektorati Nr.4 datë 13.02.2020 "Miratimi i formatit të Broshurës dhe posterit për promovimin e UGJ |
| Evidenca 2.11 | Posterat & Broshurat |
| Evidenca 2.12 | Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të informimit të maturantëve |
| Evidenca 2.13 | Relacion mbi ecurinë dhe realizimin e ditëve të hapura për maturantëve |
| Evidenca 2.14 | Formulari i vlerësimit të punës për staf akademik/staf administrativ |
| Evidenca 2.15 | Vendim i BA nr.5 datë 7.02.2017 për Miratimin e numrit të personelit për të gjitha nivelet në UGJ |
| Evidenca 2.16 | Vendim i BA nr.5 datë 7.02.2017 për Miratimin e strukturës për stafin dhe strukturën e pagës në UGJ |
| Evidenca 2.17 | Vendime BA për Miratimin e detajimit të buxhetit për vitin 2019-2020-2021 dhe rregjistri i parashikimeve publike 2019-2020 |
| Evidenca 2.18 | Rregullore e njehsuar e punës me dokumentet në UGJ |
| Evidenca 2.19 | Manual shpjegues në përdorimin e portalit U-Albania |
| Evidenca 2.20 | Funksionimi i sistemit ESSE3 RASH-UGJ |
| Evidenca 2.21 | Infrastruktura e UGJ |
| Evidenca 2.22 | Akt teknik për mbrojtjen nga zjarri 2020 |
| Evidenca 2.23 | Leja Higjeno-Sanitare 2020 |
| Evidenca 2.24 | Raporti i grupit të punës mbi kapacitetet pritëse të UGJ 2019-2020 |
| Evidenca 2.25 | Lista e studentëve të trajtuar me bursë në ciklin Bachelor 2020 |
| Evidenca 2.26 | Kërkesë për mbështetje financiare për aktivitetin e Shoqatës Sportive Studentore të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër. Projektbuxheti dhe planin e aktiviteteve që parashikohen të zhvillohen për periudhën Janar 2019- Dhjetor 2019 nga Federata Shqiptare e sportit Universitar |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| **Evidenca 2.27** | Raporti Vjetor Financiar 2018-2019-2020 |
| **Evidenca 2.28** | Print Screen i faqes WEB të UGJ |
| **Evidenca 2.29** | Print Screen i vendodhjes |
| **Evidenca 2.30** | Lista e pedagogëve me vit sabatik |
| **Evidenca 2.31** | Lista e aktiviteteve kulturore, sociale dhe edukative me pjesëmarrjen e studentëve 2019-2020 |
| **Evidenca 2.32** | Relacion i Marrëdhënieve me Publikun UGJ 2020 |
| **Evidenca 2.33** | Vendime SA mbi detajimin e buxhetit 2018, 2019, 2020 |
| **Evidenca 2.34** | Vendime të bordit të administrimit për detajimin buxheti 2018, 2019, 2020 |
| **Evidenca 2.35** | Kërkesa të njësisë bazë ku trajtohen diskutime mbi zërat e buxhetit |
| **Evidenca 2.36** | Pasqyrat financiare dhe relacione 2017, 2018,2019 |
| **Evidenca 2.37** | Procesverbal Mbledhje BA për buxhetin |
| **Evidenca 2.38** | Raport e MASR, AUDIT 2018 |
| **Evidenca 2.39** | Rregullore per organizimin dhe funksionimin e Drejtorise se Sherbimeve Ndihmes Akademike - Administrative |
| **Evidenca 2.40** | Vendimi i Rektorati Nr. 15 , datë 04.12.2019 për "Miratimin e formularit për vlerësimin e performancës së personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme". |
| **Evidenca 2.41** | Vendimi i Rektorati Nr. 15 , datë 04.12.2019 për "Miratimin e formularit për vlerësimin e performancës së personelit ndihmësakademik me karakter akademik dhe administrativ me kohë të plotë". |
| **Evidenca 2.42** | Linku i adresës të posaçme elektronike për adresimin e ankimimeve dhe shqetësimeve të studentëve dhe stafit akademik |
| **Evidenca 2.43** | Urdhër Rektori nr.4 datë 09.01.2020 "Për njehsimin e dokumentit administrativ" |
| **Evidenca 2.44** | Rregullore per mbrojtjen,perpunimin, ruajtjen dhe sigurine e te dhenave personale |
| **Evidenca 2.45** | Rregullore e Sekretarise mesimore |
| **Evidenca 2.46** | Manual përdorimi të ESSE3 student/pedagogë. |
| **Evidenca 2.47** | Bilanci i aktiveve të UGJ-së (evidencë mbi pasuritë e paluajtshme). |
| **Evidenca 2.48** | Projekti i rikonstruksionit të Godine |
| **Evidenca 2.49** | Vendime te BA për "Përcaktimin e vlerës së qerasë për sallat që disponon Universiteti "UGJ" 2018-2019-2020 |
| **Evidenca 2.50** | Vendimi i SA Nr.07, datë 07.02.2019 për "Riorganizimin e Revistës Shkencore "Kërkime Universitare" |
| **Evidenca 2.51** | Fletë inventari mbi kondicionierët sipas godinave. |
| **Evidenca 2.52** | Fletë inventari për materiale kryesore |
| **Evidenca 2.53** | Vendimi i Rektorati Nr. 15, datë 04.12.2019 për "Për administrimin e dokumentacionit akademik dhe administrativ të Fakulteteve dhe Departamenteve". |
| **Evidenca 2.54** | Vendime BA për "Miratimin e listës së studentëve që përfitojnë bursë dhe përjashtimet nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2019-2020". |
| **Evidenca 2.55** | Regjistrimi i studentëve – dosja personale e një studenti nga hyrja deri në diplomim. |



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

## 3 – FUSHA E VLERËSIMIT: KURRIKULA

| Nr. Evidencës | Titulli |
|---|---|
| **Evidenca 3.1** | VKM e Hapjes së UGJ |
| **Evidenca 3.2** | Urdhër Hapje e Fakultetit Ekonomik |
| **Evidenca 3.3** | Vendimi SA Nr.05 datë 07.02.2019 për Miratimin e Kritereve në programet e studimit për vitin akademik 2020-2021 |
| **Evidenca 3.4** | Vendime të Dekanateve për miratimin e kritereve dhe kuotave Departament/Fakultet |
| **Evidenca 3.5** | Print Screeni Faqes U-Albania për kriteret |
| **Evidenca 3.6** | Shembuj kriteresh të pranimit të ciklit të dytë |
| **Evidenca 3.7** | Dosje programi studimi Bsc. Infermieri e Përgjithshme FSHN |
| **Evidenca 3.8** | Dosje programi studimi MP Administrim Publik FE |
| **Evidenca 3.9** | Dosje Programi Studimi Msc Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Arkeologjike |
| **Evidenca 3.10** | Dosje programi studimi 2-vjeçar Udhërrëfyes Turistik |
| **Evidenca 3.11** | Procedurë hapje programi MP. Shkencat Infermierore |
| **Evidenca 3.12** | Raport Vjetor FE (2019-2020) |
| **Evidenca 3.13** | Raport Vjetor FSHN (2019-2020) |
| **Evidenca 3.14** | Raport Vjetor FESHSH(2019-2020) |
| **Evidenca 3.15** | Raport Vjetor Departamenti Matematikë Informatikë Fizikë(2019-2020) |
| **Evidenca 3.16** | Raport Vjetor Departamenti Kontabilitet Finance (2019-2020) |
| **Evidenca 3.17** | Raport Vjetor Departamenti DEMM (2019-2020) |
| **Evidenca 3.18** | Riorganizim/ndryshim programesh Bachelor & Master |
| **Evidenca 3.19** | Riorganizim/ndryshim programesh Bachelor & Master 2020 |
| **Evidenca 3.20** | Syllabus lënde i miratuar. Departamenti i Gjuhe Letersise dhe Qyteterimit Grek FESHSH |
| **Evidenca 3.21** | Kurse të formimit të vazhduar për mësuesit të ofruar në kuadrin e projektit Teavet |
| **Evidenca 3.22** | Vendime/ urdhra te MASR per hapje programesh të reja studimi |
| **Evidenca 3.23** | Plan Strategjik FESHSH |
| **Evidenca 3.24** | Plan Strategjik FSHN |
| **Evidenca 3.25** | Plani Strategjik FE |
| **Evidenca 3.26** | Print Screen i faqes WEB për ofertën akademike për programin mësimor Bsc. Administrim Publik |
| **Evidenca 3.27** | Vendime Senati për provimin e Gjuhës së Huaj (MSH)2017, 2018. 2019 |
| **Evidenca 3.28** | Vendim Senati Nr.-09 Dt.-05.02.2020 për ofrim programesh të përbashkëta me SHLUJ Marlin Barleti |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | Vendim Senati Nr.-10 Dt.-05.02.2020 për ofrim programesh të përbashkëta me Universitetin e Maçerates |
| **Evidenca 3.29** | Shpërndarja e ngarkesës mësimore për stafin akademik 2020-2021 |
| **Evidenca 3.30** | Ngarkesa mësimore e personelit akademik 2019-2020 drejtuar ASCAL |
| **Evidenca 3.30.1** | Vendim i SA. Nr 23 datë 8.11.2019 për miratimin e Ngarkesës mësimore e personelit akademik 2019-2020 |
| **Evidenca 3.31** | Vendimi i Bordit të Administrimit Nr 19 datë 12.02.2019 për pagesën e mbingarkesës së pedagogëve për vitin akademik 2019-2020 |
| **Evidenca 3.32** | Modeli Marrëveshjes për kohën e punës të stafit akademik |
| **Evidenca 3.32.1** | Marrëveshja për kohën e punës të stafit akademik.2017-2018 |
| **Evidenca 3.33** | Rregullore programi Bsc. Matematikë Informatikë |
| **Evidenca 3.34** | Regullore programi MP. Administrim Publik |
| **Evidenca 3.35** | Rregullore programi studimi MSC Arkeologji dhe Administrim i Pasurive Arkeologjike |
| **Evidenca 3.36** | Rregullore programi studimi 2 Vjecar Edukatore për Zhvillimin e Femijërisë së Hershme |
| **Evidenca 3.37** | Suplementi i Diplomës |
| **Evidenca 3.38** | Listë e konferencave studentore. |
| **Evidenca 3.39** | Statistika në lidhje me nr e pedagogeve me kohë të plotë dhe nr. e pedagogëve me kohë të pjesshme, në programet e studimit të ciklit të parë dhe ciklin e dytë në çdo fakultet |
| **Evidenca 3.40** | Procedurë ekuivalentimi studimesh rifillim studimesh |
| **Evidenca 3.41** | Procedurë Transferimesh |
| **Evidenca 3.42** | Aktivitete kulturore dhe edukative me pjesëmarrjen e studentëve, të cilat synojnë gjallërimin e jetës studentore |
| **Evidenca 3.43** | Plan mësimor Mësuesi ndihmës në Edukimin gjithëpërfshirës |
| **Evidenca 3.44** | Korrespeondenca me QSHA |
| **Evidenca 3.45** | Rregulloret e praktikave mësimore |
| **Evidenca 3.46** | Urdhër Rektori Nr 17 datë 18.03.2020 për Platformën e mësimit online |



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

## 4- FUSHA E VLERËSIMIT: MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KËRKIMI

| Nr. Evidencës | Titulli |
|---|---|
| Evidenca 4.1 | Shembull orari mësimor |
| Evidenca 4.2 | http://uogj.edu.al/oraret-per-vitin-akademik/ |
| Evidenca 4.3 | Lista e mentorëve të jashtëm që mbikëqyrin praktikat mësimore |
| Evidenca 4.4 | Lista e librave të miratuar për literaturë bazë ne rang departamenti |
| Evidenca 4.5 | Shembull i miratimit në departament i një teksti që do përdoret si literaturë bazë ne rang Fakulteti |
| Evidenca 4.6 | Lista e botimeve të blerë nga UGJ në funksion të programeve mësimore |
| Evidenca 4.7 | Lista e botimeve të dhuruara në UGJ nga donatorë |
| Evidenca 4.8 | Rregullore Studimi |
| Evidenca 4.9 | Databaze e pyetesoreve te studenteve ne UGJ |
| Evidenca 4.10 | Vendimet për ngritjen e GVB për programet e studimit 2019, 2020 |
| Evidenca 4.11 | Grupi pilot i anglishtes |
| Evidenca 4.12 | Vendim SA Nr.7, datë 18.01.2017 "Miratimin e formularit për vlerësimin e performancës së personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme" |
| Evidenca 4.13 | Lista e personelit ndihmësakademik dhe administrativ |
| Evidenca 4.14 | Vendim SA Nr.31datë 22.09.2020"Për riorganizimin e grupeve mësimore, kërkimore-shkencore të njësive bazë të Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër |
| Evidenca 4.15 | Vendimet e Dekanantit mbi propozimet e Departamenteve për riorganizimin e grupeve mësimore, kërkimore-shkencore të njësive bazë të Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër |
| Evidenca 4.16 | Tabela nga financa me kryetarët e grupeve kërkimore për evidentim të pagës |
| Evidenca 4.17 | Thirrjet AKSHSHI që i dërgohet stafit për të aplikuar për projekte nga zyra e projekteve-email |
| Evidenca 4.18 | Lista e konferencave, ku stafi akademik i UGJ-së është pjesëmarrës |
| Evidenca 4.19 | Vendime departamenti që kanë grupe kërkimore ku përcaktojnë fushat e studimit |
| Evidenca 4.20 | Kërkesë për leje për pjesëmarrje nëkonferenca apo projekte |
| Evidenca 4.21 | Konferenca dhe aktivitete të financuara nga UGJ |
| Evidenca 4.22 | Vendim Rektoratit Nr. 14, datë 27.11.2019, Për miratimin e përbërjes së |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | bordit editorial dhe bordit shkencor të Buletinit Shkencor të Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër |
| **Evidenca 4.23** | Çelje date shtesë provimi |
| **Evidenca 4.24** | Marrëveshjet me institucionet publike dhe jo publike për kryerjen e praktikave mësimore |
| **Evidenca 4.25** | Vendimi i SA nr. 05, date 02.02.2021 Per ngritjen e qendres nderdisiplinore te kerkimit dhe zhvillimit |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" · GJIROKASTËR

## 5- FUSHA E VLERËSIMIT: STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| Nr. Evidencës | Titulli |
|---|---|
| **Evidenca 5.1** | Urdhër Nr. 40, datë 16.07.2018" Per plotesimin e dokumentacionit nga K/sekretaria e universitetit dhe sekretarite mesimore te fakulteteve" |
| **Evidenca 5.2** | Raporti student/pedagog për çdo Fakultet |
| **Evidenca 5.3** | Linku Universitetit Faqe Zyrtare e Facebook Media Sociale |
| **Evidenca 5.4** | Lista e studentëve me aftësi të kufizuar |
| **Evidenca 5.5** | Evidencë propozim kuotash për romët dhe ballkano-egjiptianët. |
| **Evidenca 5.6** | Kërkesë për shtyrje ose afrim datë provimi e miratuar nga Dekani |
| **Evidenca 5.7** | Evidencë për studentët part-time |
| **Evidenca 5.8** | Rregullore e bibliotekës |
| **Evidenca 5.9** | Kartelë regjistrimi biblioteke |
| **Evidenca 5.10** | Statuti i Këshillit Studentor |
| **Evidenca 5.11** | Vendim Senati nr 17 datë 11.07.2019 Rregulloren e Organizimit Të Zgjedhjeve për KS |
| **Evidenca 5.12** | Rregulloren e Organizimit të Zgjedhjeve për KS |
| **Evidenca 5.13** | Deklaratë e Senatit Akademik mbi miratimin e kërkesave të studentëve pas protestës |
| **Evidenca 5.14** | Database Alumni |
| **Evidenca 5.15** | Database të punësuarit në UGJ |
| **Evidenca 5.16** | Formulari gjurmimit të studentëve |
| **Evidenca 5.17** | Urdhër mbi ngritjen dhe funksionimin e të dhënave për rregjistrimin e studentëve në të dy ciklet e studimit |
| **Evidenca 5.18** | Vendim Rektorati nr 2, datë 13.2.2020 mbi miratimin e ngritjes së grupeve të punës për ditët e këshillimit të karrieres |
| **Evidenca 5.19** | Lista e studentëve të UGJ sipas programeve të studimit |
| **Evidenca 5.20** | Lista e përdoruesve të U Library |
| **Evidenca 5.21** | Lista e transferimeve në UGJ dhe të larguarit nga UGJ |
| **Evidenca 5.22** | Plani i aktiviteteve Fakultet/ Departament për studentët |
| **Evidenca 5.23** | Korrespondeca për këshillimin e karrierës |
| **Evidenca 5.24** | Plan Vjetor i punës përkëshillimin e karrierës |
| **Evidenca 5.25** | Kategoritë e individëve që përjashtohen nga tarifa e shkollimit |
| **Evidenca 5.26** | Certifikata e pjesëmarrjes në Kampinonatin Ndërkombëtar të Futbollit në sallë |
| **Evidenca 5.27** | Kalendari i zhvillimit të ditëve të informimit të maturantëve |
| **Evidenca 5.28** | Procedure per zhvillimin e Sondazhit Kombetar te Studenteve |



REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR